



LEVIZJA E GRUAS PER ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



RAPORT

Produktet dhe Siguria Kimike në Ballkan

Bashkëpunimi i Shoqërisë Civile në Acquis Communitare të BE-së

Vlerat për Konsumatorët dhe Përgjegjësia e Bashkëpunimit



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



MAJ, 2011

Analistët e Raportit:

Ermal Dizdari, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
Arjan Cara, Ekspert Instat
PhD Evis Qaja, Eksperte Ekzekutive LGZHI
Ulpiana Shpata, Përkthyesë e Gjuhës Angleze

Botimi:

Lëvizja e Gruas për Zhvillim Integral
LGZHI
Adresa: Rruga "Gjergj Fishta"
Tel: ++355 42 2428 148
Fax: ++355 42 2428 148
E-mail: evis_qaja@lgzhi.com
Web site: lgzhi.com

PËRMBAJTJA E LËNDËS:

1. HYRJA
1.1 PËRKUFIZIME
1.2 KLASIFIKIMI I SUBSTANCAVE DHE I PREPARATEVE KIMIKE
1.3 VLERËSIMI I RREZIKUT TË SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME PËR SHËNDETIN E NJERIUT DHE MJEDISIN
1.4 MBETJET INDUSTRIALE DHE TË RREZIKSHME
1.4.1 NDOTJA E AJRIT
1.4.2 MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT
1.4.3 MONITORIMI I UJRAVE
1.4.4 UJRAT TOKËSORE
1.4.5 UJRAT SIPËRFAQËSORE
1.4.6 UJI I PIJSHËM
1.5 SASIA E SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME TË GRUMBULLUARA SIPAS KATEGORISË
1.5.1 PËRSHKRIMI I ZONAVE PROBLEMATIKE
1.5.2 SHQETESIMET PRIORITARE NË LIDHJE ME KIMIKATET
2. KUADRI LIGJOR LIDHUR ME KIMIKATET
2.1 OBJEKTIVI POLITIK
3. RREGULLAT PËR KLASIFIKIMIN, PAKETIMIN DHE ETIKETIMIN E KIMIKATEVE (SI PËR SUBSTANCAT ASHTU DHE PËR PREPARATET)
4. PROCEDURA PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE DHE VLERËSIMIN E RREZIQEVE PËR KIMIKATET
5. LODRAT DHE KUADRI LIGJOR
5.1 OBJEKTIVI POLITIK
5.2 SITUATA AKTUALE
5.2.1 KUADRI LIGJOR EKZISTUES
5.2.2 DJEGSHMËRIA
5.2.3 VETITË KIMIKE
6. SITUATA NË TERREN



7. MBROJTJA E KONSUMATORIT ,LIGJET PËRKATËSE	
7.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR MENAXHIMIN E SUBSTANCAVE DHE TË PREPARATEVE TË RREZIKSHME	
7.2 AMBALAZHIMI I SUBSTANCAVE DHE I PREPARATEVE TË RREZIKSHME PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT	
7.3 RUAJTJA E SUBSTANCAVE DHE PREPARATEVE KIMIKE	
7.4 RUAJTJA E SUBSTANCAVE DHE PREPARATEVE KIMIKE	
8. MEKANIZMAT JO RREGULLATORE PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE	
9. KRAHASIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË LIDHJE ME KIMIKATET ME UDHËZIMET E BE-SË	
10. DEKLARATA	
11. ZONAT PROBLEMATIKE QË SHFAQIN NDOTJE ME KIMIKATE NË SHQIPËRI	
11.1 FUSHA NAFTËMBAJTESE E PATOS – MARINËZ	
11.2 KIMIKATET NË DURRËS (ZONA E PORTO ROMANOS)	
11.3 STACIONI HEKURUDHOR, BAJZË	
12. RAPORTIME NË MEDIA	
13. ZHVILLIMI DHE KONKLuzionET E PYETËSORIT	
14. ANALIZIMI	
15. PYETËSOR	
16. BIBLIOGRAFIA	
16.1 Aneksi I (Dokumenta zyrtare)	
16.2 Aneksi II (Legjislacione)	
16.3 Aneksi III (Web-side)	

HYRJA

Raporti i paraqitur më poshtë ka për qëllim të paraqesë një situatë aktuale të problemeve që ka Shqipëria me përdorimin dhe menaxhimin e kimikateve, si dhe të analizojë me fakte konkrete punën që është bërë dhe po bëhet nga instancat përkatëse për këtë problem.

Raporti bazohet në 6 shtylla kryesore:

Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri në lidhje me problemet e kimikateve.

Si kanë lindur këto probleme pse janë zhvilluar dhe si po përparojnë. Fokusi është ndalur tek zonat e nxehta dhe më problematike në lidhje me kimikatet në Shqipëri. Gjithashtu duke përmendur zonat më problematike, janë përmendur edhe llojet e kimikateve më të përhapura në vendin tonë.

Legjislacioni aktual në lidhje me preparatet dhe substancat kimike.

Është paraqitur kuadri i plotë ligjor, i cili paraqet mënyrën se si menaxhohen substancat kimike, rreziqet që ato kanë, çfarë procedurash ndiqen për minimizimin e këtyre rreziqeve sidomos për njerëzit dhe nga cilët organizma shtetërorë menaxhohen këto procese.

Kimikatet tek lodrat dhe kuadri ligjor.

Këtu jemi ndalur të përcaktojmë rëndësinë e problemit të kimikateve tek lodrat për ruajtjen e shëndetit të fëmijës. Është paraqitur kuadri ligjor për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave. Çfarë procedurash janë ndjekur për evidentimin dhe sekuestrimin e këtyre lodrave “të rrezikshme”

Mbrojtja e konsumatorit dhe kuadri ligjor.

Këtu janë pasqyruar ligjet dhe procedurat që janë ndjekur në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit nga rreziqet që paraqesin kimikatet.

Krahasimi i Legjislacionit shqiptar në lidhje me kimikatet me udhëzimet e BE.



Çfarë përmban Legjislacioni shqiptar në lidhje me kimikatet dhe punën e organizmave përkatës në lidhje me direktivat dhe udhëzimet e BE për kimikatet.

Raportime të mediave për situatën aktuale dhe problematikat mjedisore në lidhje me kimikatet, si dhe deklaratat e institucioneve përgjegjëse në lidhje me këto probleme.

SHKURTIME

ISHP	- Instituti i Shëndetit Publik
KM	- Këshillit të Ministrave
IGJSH	- Inspektimi Gjeologjik Shqiptar
IH	- Institutin e Hidrometeorologjisë
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
METE	- Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe të Energjitikës
MIE	- Ministria e Industrisë dhe e Energjitikës
ONAK	- Organizata e Ndalimit të Armëve Kimike
VNM	- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
KNAK	- Konventa për Ndalimin e Armëve Kimike
MAN	- Mbrojtja e Ajrit nga Ndotja
AMMN	- Administrimi Mjedisor i Mbetjeve të Ngurta
PKMM	- Programi Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
IB	- Inspektorati Bashkiak
ISSH	- Inspektorati Sanitar Shtetëror
ISHM	- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit
IM	- Inspektorati i Mjedisit
ARM	- Agjencia Rajonale e Mjedisit



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



ISHP	- Inspektorati Shtetëror i Punës
ISHSH	- Inspektoriati Shtetëror i Shëndetit
GHS	- Globally Harmonized System (Sistemi Harmonizuar Globalisht)
MSA	- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MMPAU	- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
IQT	- Inspektorati Qendror Teknik
DPD	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
MRP	- Ministria e Rendit Publik
PKMKSH	- Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri
PKZMSA	- Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes e Stabilizim Asociimit
NEHAP	- Plani Kombëtar i Veprimit për Shëndetin dhe Mjedisin
CEHAPE	- Plani European i Veprimit për Fëmijët, Shëndetin dhe Mjedisin
PVMSH	- Plani i Veprimit Mjedisor dhe Shëndetësor
PKMM	- Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit
REC	- Qendra Rajonale e Mjedisit
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
BEZR	- Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindertim

1. HYRJJE

Kushtet makroekonomike në Shqipëri nga fillimi i reformës në 1990 - 1991 deri në ditët e sotme janë karakterizuar me procese dinamike, të lidhura dhe të shoqëruara me një rënie të konsiderueshme të prodhimit të kimikateve, si dhe të politikave monetare të kufizuara për prodhimin e tyre etj. Rezultatet negative të këtij prodhimi janë si pasojë e ngadalësimit të reformave strukturale të privatizimit dhe kushtet e jashtme specifike, furnizimi gati total nga importi nga vende fqinje e nga vende të tjera me ekonomi të zhvilluar, mos korrespondimi i importit të vazhdueshëm dhe të ndonjë mundësie për export të lëndëve të para ose të gjysëmprodukteve etj.

Gjendja paraqitet optimiste duke parë reagimin dhe të investitorëve privatë të cilët duke parë dhe efektivitetin e prodhimit të disa kimikateve dhe për te cilat lëndët e para gjenden në vend, po parashikojnë realizimin e disa investimeve me interes. Një hap i tillë do të bëjë që vendi ynë të hyjë në fazën tjetër të tranzicionit ekonomik.

Prodhimi industrial është përgjysmuar, dhe rënia më e madhe është në industrinë e prodhimeve kimike, si acid sulfurik nitrik, fosforik, të sodës kaustike, sodës solvej, superfosfatit, plehërave azotike, pesticideve, të prodhimit të naftës e gazit të SiO₂, glicerines, O₂, S, SO₂, CO₂ etj. Rënia e ndjeshme në prodhimin e makinerive dhe industrinë e përpunimit të metaleve, në përpunimin e drurit dhe metalurgjisë la trashëgim shumë kimikate të papërdorura, që sot kanë krijuar probleme për ambientin. Në vendin tonë mbyllja e ndërmarrjeve prodhuese veç papunësisë solli edhe braktisjen e mjediseve të punës dhe lënien jashtë kontrollit të kimikateve gjendje, mbetjeve toksike dhe të rrezikshme, duke rritur shumë shkallën e ekspozimit ndaj riskut në zona të caktuara, që për fat të keq janë populluar nga shtresa të varfëra të popullsisë, të migruar kohët e fundit nga zonat të ndryshme të vendit.

Një nga treguesit e praktikave të përdorimit të paqëndrueshëm është dhe ndotja nga industrinë e së kaluarës dhe krijimi për këtë arsye i zonave të nxehta mjedisore (hot-spote). Aktualisht vendi ka 9 zona që bartin mbeturina të tilla toksike e kancerogjene të lëna në më të shumtën e rasteve jashtë kontrollit. Pesë prej tyre janë konsideruar si zona të nxehta mjedisore edhe nga studime ndërkombëtare . Këto përmbajnë mbetje të mërkurit, lindanit, kromit 6 valent, tiramit, dioksiave, furamit dhe mbetje të tjera të pesticideve ose të produkteve të naftës si dhe instalime përkatëse të braktisura .

Rehabilitimi mjedisor i këtyre zonave është një nga prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit Socio- Ekonomik të vendit dhe Plani Kombëtar të veprimit për Mjedisin , i lidhur ngushtë me nevojën për përmirsimin e shëndetit publik dhe të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm . Ai shihet si një mundësi për rritjen e potencialit turistik të zonave bregdetare pranë të cilave ndodhen disa nga pikat e nxehta (*Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri, 2006*)



1.1 PËRKUFIZIME

Sipas Nenit 4 të Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003, *Për substancat dhe preparatet kimike*, japim shpjegimin e temave që lidhen me substancat kimike.

1. "Substanca kimike" që më poshtë do të quhen substanca, janë elementet kimike dhe komponimet e tyre në gjendje natyrore ose të fituara nga një proces prodhimi, përfshirë shtesat dhe solventet kryesore për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre, si dhe ndonjë papastërti me origjinë natyrore ose të marrë në procesin e prodhimit, me përjashtim të solventeve që mund të veçohen nga substanca pa ndryshuar përbërjen e saj ose pa ndikuar në stabilitetin e saj.

2. "Preparate kimike", që më poshtë do të quhen preparate, janë përzierjet ose solucionet e përbëra nga dy ose më shumë substanca kimike.

3. "Klasifikim" është vlerësimi, sipas të cilit substanca ose preparati ka një ose më shumë veti të rrezikshme dhe përcaktimi më tej i kategorive të rrezikut individual.

4. "Shpërndarës" është personi juridik ose fizik, i autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, i cili ruan dhe ua shpërndan substancat ose preparatet personave të tjerë dhe nuk ndikon drejtpërdrejtë në vetitë e substancave dhe preparateve, nëpërmjet veprimtarisë të tij.

5. "Vlerësim" është cilësimi i një vetie të rrezikshme, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.

6. "Importues" është personi juridik ose fizik, vendas ose i huaj, i cili fut në territorin e Republikës së Shqipërisë një substancë ose preparat kimik.



7. "Eksportues" është personi juridik ose fizik, vendas ose i huaj, i cili nxjerr nga territori i Republikës së Shqipërisë një substancë ose preparat kimik.

8. "Tregtim" quhet kalimi i substancave dhe preparateve kimike të një personi tjetër fizik ose juridik. Në kuptim të këtij ligji, në tregtim përfshihet edhe importi.

9. "Tranzit" quhet çdo substancë dhe preparat kimik, që pas hyrjes në territorin shqiptar dhe deri në daljen e tij nga ky territor, nuk i nënshtrohet asnjë lloj procesi ose trajtimi.

10. "Administrimi i substancave dhe preparateve" është një veprimtari, objekt i së cilës janë substancat dhe preparatet, në veçanti, prodhimi, importi, eksporti,

tranzitimi, përdorimi, ruajtja, ambalazhimi, etiketimi, transportimi brenda territorit të subjektit, si dhe asgjësimi i tyre.

11. "Regjistrimi i substancave" është regjistrimi i substancave në Regjistrin Kombëtar, që mbahet nga Ministria e Mjedisit, në bazë të të dhënave me shkrim për substancat, në përputhje me këtë ligj.

12. "Rregullore e sigurimit teknik" është një përmbledhje e të dhënave të identifikimit për prodhuesin ose importuesin për substancat ose preparatet e rrezikshme dhe të dhënat që kërkohen për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të kafshëve dhe të mjedisit.

13. "Substanca dhe preparate të rrezikshme" janë substancat dhe preparatet, që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme, të klasifikuara sipas kushteve të vendosura në këtë ligj.



1.2 KLASIFIKIMI I SUBSTANCAVE DHE I PREPARATEVE KIMIKE

Sipas Nenit 5 të Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003, *Për substancat dhe preparatet kimike*, substancat dhe preparatet kimike për shkak të vetive, klasifikohen:

1. Eksplozive, që mund të veprojnë në mënyrë ekzotermike, pa praninë e oksigjenit, me zhvillim të shpejtë gazesh ose që vetëndizen dhe digjen shpejt në kushte të caktuara ose që shpërthejnë me ngrohje kur vendosen në kontenerë johermetikë.

2. Oksiduese, që në kontakt me substanca të tjera, në veçanti me substanca të ndezshme, shkaktojnë reaksion ekzotermik të fuqishëm.

3. Ekstremisht të ndezshme, që në gjendje të lëngët kanë pikë flakërimi më të ulët se 0°C dhe pikë vlimi më të ulët se 35°C ose që janë të ndezshme në gjendje të gaztë, në kontakt me ajrin në temperaturë normale të dhomës dhe presion atmosferik normal.

4. Shumë të ndezshme, që:

a) mund të nxehen në mënyrë spontane dhe pastaj të digjen në kontakt me ajrin në temperaturë normale të dhomës, presion normal atmosferik dhe pa prani të energjisë;

b) mund të digjen lehtësisht në gjendje të ngurtë, si pasojë e një kontakti të shkurtër me një burim zjarri, ndezjeje dhe vazhdojnë të digjen ose të tymosin edhe pas largimit të burimit të zjarrit;

c) kanë një pikë ndezjeje në gjendje të lëngët më të ulët se 21°C dhe nuk janë ekstremisht të ndezshme;

ç) në kontakt me ujin ose ajrin e lagët çlirojnë gaze shumë të rrezikshme, në sasi të paktën 1 litër/kg.h

5. Të ndezshme, që e kanë pikën e flakërimin 21°C deri në 55°C .

6. Shumë helmuese, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë, edhe në sasi të vogla, mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit, ose vdekje.

7. Helmuese, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë, edhe në sasi të vogla, mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit, ose vdekje.

8. Të dëmshme për shëndetin, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë, edhe në sasi të vogla, mund të shkaktojnë dëmtime akute ose kronike të shëndetit, ose vdekje.

9. Korrozive, që në kontakt me indet e gjalla jetësore mund t'i shkatërrojnë ato.

10. Irrituese, që nuk kanë vetitë e substancave korrozive, por që nga kontakti i drejtpërdrejtë për një kohë të gjatë me lëkurën ose membranat mukoze mund të shkaktojnë inflamacione.

11. Sensibilizuese, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë hipersensibilitet dhe për pasojë pas një ekspozimi tjetër, shfaqen simptomat karakteristike të tij.

12. Kancerogjene, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rrisin frekuencën e shfaqjes së kancerit.

13. Mutagjene, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rrisin frekuencën e shfaqjes së dëmtimeve gjenetike.

14. Dëmtuese për riprodhimin, që pas thithjes, gëlltitjes ose depërtimit në lëkurë mund të shkaktojnë ose të rrisin frekuencën e dëmtimeve në funksionin e riprodhimit ose në aftësinë riprodhuese të meshkujve ose të femrave.

15. Të rrezikshme për mjedisin, që pas futjes në mjedis, përbëjnë ose mund të përbëjnë një rrezik të menjëhershëm ose të mëvonshëm për mjedisin.

1.3 VLERËSIMI I RREZIKUT TË SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME PËR SHËNDETIN E NJERIUT DHE MJEDISIN

Sipas Nenit 13 të Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003, *Për substancat dhe preparatet kimike*, vlerësimi i rrezikut të substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin realizohet në këtë formë:

1. Lista e substancave të rrezikshme, që prej natyrës së tyre përbëjnë një rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ministria e Mjedisit, së bashku me ministritë e tjera të ngarkuara nga ky ligj, marrin masa për vlerësimin e rrezikut për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin për substancat e përfshira në listë, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Proçedura për vlerësimin e rrezikut të substancave të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

4. Proçedura për vlerësimin e rrezikut të substancave të rrezikshme për mjedisin, përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mjedisit.

5. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të rrezikut të substancave të rrezikshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës, vendos kushtet për hedhjen e këtyre substancave në treg.

1.4 MBETJET INDUSTRIALE DHE TË RREZIKSHME

Në vitin 1990 industria kontribuonte me më shumë se 37% të GDP-s : kjo pjesë ra në vitin 1999 rreth 12%. Sektorët kryesorë të industrisë ishin , metalurgjia, rafinimi i naftës dhe prodhimet kimike. Shqipëria është e pasur me burime minerale . Sipas Studimeve Gjeologjike rezervat potenciale burimore të mineraleve janë:(në milion tone) : krom 5 : bakër 45-50 : nikel 500 : qymyr 350 . Aktivitetet industriale në të shkuarën dhe të tanishme janë të bazuara mbi përdorimin e burimeve natyrore si lëndë



e parë . Gjatë viteve të fundit, prodhimi industrial i shumë produkteve të mëdhaja ra në 50-70% , disa produkte nuk prodhohen më. *Këto produkte përfshijnë të gjitha koncentratet metalurgjike , nikelin , prodhimet kimike të cilat gjeneruan mbetje industriale të rrezikshme të mbetura fushave ose në impiantet e ndaluara nga puna.* Arsyet kryesore për këtë janë ndryshimet e kushteve sociale dhe ekonomike. Prodhimet industriale tani konsistojnë në minierat dhe pasurimi i mineraleve të bakrit dhe kromit, qymyrit, përpunimi i naftës dhe materialeve të ndërtimit kështu që shumica e mbetjeve industriale formohet nga këto industri. Për ndërmarrjet industriale të cilat janë mbyllur, problemi kryesor mjedisor është akumulimi i mbetjeve nga operacionet e mëparshme. Në vitin 2000 sasitë më të larta të mbetjeve industriale të rrezikshme u formuan në industrinë e kromit dhe të bakrit.

Industria kimike Shqiptare në këtë periudhë tranzicioni ka pësuar një rënie të ndjeshme. Prodhimi i pesticideve, plehrave kimike, të sodës, acidit sulfurik, glicerinës etj , të cilat kishin prioritet të veçantë në të kaluarën sepse duhej mbajtur bujqësia dhe industria me lëndë të parë për nevojat e vendit tashmë nuk ekzistojnë më .

Sot vendi ynë ka të zhvilluar industrinë e çimentos, pjesërisht metalurgjinë, industrinë e mallrave të konsumit të gjerë të cilat kanë nevojë për lëndë të parë e ndihmuese kimikate të cilat kryesisht importohen e në pak raste prodhohen dhe kërkohet treg për eksport si O₂ , N₂ .

Si pasojë e këtij zhvillimi industrial e bujqësor të arritur Shqipëria importon pesticidet, plehra kimike, kimikate të llojeve të ndryshme për detergjentët, vajrat lubrifikantë, pastrimin kimik, ndërtimin etj , impakti mjedisor i të cilave është i lidhur ngushtë me përpunimin, ruajtjen dhe transportin e tyre. Disa nga problematikat që ato krijojnë janë:

1.4.1 NDOTJA E AJRIT

Ndotja e ajrit si pasojë e emisioneve nga djegjet e karburanteve, transportit automobilistik, ndërtimeve të pakontrolluara është bërë problematike në zonat kryesisht industriale, të industrisë së çimentos, metalurgjisë, rafineritë e naftës, rrjeti i transportit automobilistik etj.



Ndotësit kryesorë të krijuar janë PM10 dhe PM 2.5 të krijuara nga industria e çimentos dhe ndërtimet e shumta në të gjithë vendin; i NOx të krijuara nga rafinimi i naftës apo transporti automobilistik ; i SOx e CO2 të krijuara nga Termocentralet , gjeneratorët e rrymës, lënda e amonjakut e çliruar nga procese të industrisë ushqimore , fenole të çliruar nga industria metalurgjike, rafineritë etj .

Faktor i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë janë aksidentet industriale të cilat ndotin ajrin në forma të caktuara, zjarret në industrinë e naftës, djegia e puseve të naftës ose përdorimi pa kriter i pesticideve në bujqësi.

1.4.2 MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT

Detyrimi ligjor për të monitoruar cilësinë e ajrit rrjedh nga Ligjet mbi Mbrojtjen Mjedisore dhe mbi Inspektoriatin Shtetëror të Shëndetit. Është e rëndësishme të theksojmë se rregullat dhe rregulloret për forcimin e këtyre dy ligjeve janë të paplotësuara: ato nuk parashtrojnë në mënyrë të qartë definicionet dhe nuk japin detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme. Kjo ka çuar drejt keqkuptimit dhe keqinterpretimit të vazhdueshëm, i cili ka ndikuar në proces.

Instituti i Shëndetit Publik operon kontrollin kryesor të ndotjes së ajrit në Tiranë. Laboratori nisi funksionimin në vitin 1997 dhe është i pajisur me instrumenta moderne. Gjithashtu ky Institut monitoron cilësinë e ajrit në qytetet e Tiranës, Korçës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Fierit dhe Vlorës. Për arsye të kufizimit të burimeve teknike dhe financiare monitorimi i ajrit mesatarisht bëhet 5 ditë në muaj për secilin qytet. Kjo bën një total jo më shumë se 60 ditë në vit në çdo qytet, e cila rezulton në një të dhënë mesatare rreth 16%. Kjo është shumë poshtë nga minimumi prej 247 ditësh në vit që rekomandon Organizata Botërore e Shëndetësisë . Monitorimi pasiv është përdorur vetëm për monitorimin e O3 dhe disa matje paralele të NO2 . Gjithashtu, I.Sh.P ka një stacioni automatik monitorimi për cilësinë e ajrit që nga viti 1996. Ky stacion ndodhet në Tiranë dhe mat pa ndërprerje dinamikën e ndotësve të O3 , SO2 , CO dhe NOx . Programi i monitorimit automatik u ndërpre në 1999 për mungesë të pjesëve të riparimit dhe të shërbim-kalibrimit. Laboratori i ndotjes së ajrit në I.Sh.P është duke planifikuar të rinisë monitorimin automatik sipas programit CARDS.

Në situatën e rritjes së trafikut urban, shpeshësia e regjistrimit është e pamjaftueshme. Ndërkohë që përqendrimet e PM10 përgjithësisht regjistrohen 4-5 herë në muaj, për të pasur të dhëna të mjaftueshme interpretimi kërkohet një vëzhgim prej të paktën 247 ditësh në vit.

1.4.3 MONITORIMI I UJRAVE

Një dekret i Këshillit të Ministrave mbi Monitorimet në Republikën e Shqipërisë në mënyrë që të ndajë dhe qartësojë detyrat e instituteve të ndryshme dhe të shmangte boshllëqet dhe duplikimet kushtëzon se kush duhet të monitorojë tregues të veçantë. Në vitin 2001 Ministria e Mjedisit, e cila është përgjegjëse për monitorimin e ambjentit subkontraktoi monitorimin e ujit me disa Institucione të specializuara të vendit.

1.4.4 UJRAT TOKËSORE

Për afro gjysëm shekulli Inspektimi Gjeologjik Shqiptar ka monitoruar ujërat tokësor , veçanërisht për sasinë, cilësinë dhe lëvizjen e ujërave. I.Gj.Sh ka ndërmarrë edhe studime hidrologjike për ujërat tokësore. Me ligj, Inspektimi duhet të mbrojë akuiferet, por informacioni mbi sasinë e ujit prej akuifereve nuk i raportohet. I.Gj.Sh thekson se përdorimi i vazhdueshëm i ujërave tokësore është i paqëndrueshëm për shkak se është shumë intensiv në disa akuifere dhe në disa zona.

1.4.5 UJRAT SIPËRFAQËSORE

Monitorimi i lumenjëve i është subkontraktuar nga Ministria e Mjedisit me Institutin e Hidrometeorologjisë. Sipas Raporteve Mjedisore të këtij Instituti ujërat sipërfaqësore janë të kategorisë së parë për nga cilësia, por gjithashtu raporti tregon se stacionet e monitorimit janë lokalizuar larg nga burimet e ndotjes. Monitorimi i ujërave sipërfaqësore është ulur shumë. Shumica e 150 stacioneve nuk funksionojnë më, sepse ato nuk kanë staf të mjaftueshëm , paisje për mostrat dhe analizat ose makina. Sot vetëm dy seri rezultatesh i jepen Ministrisë së Mjedisit për çdo vit .

1.4.6 UJI I PIJSHËM

Uji i pijshëm dhe ai i bregdetit monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë e subkontraktuar nga Ministria e Mjedisit. Rreth 15 parametra monitorohen, përfshi standardet globale të fiziko-kimisë dhe bakterieve. Pesticidet rrallë monitorohen ndërsa hidrokarburet nuk monitorohen. Monitorimi i zonave të plazhit në bregdet gjatë sezonit turistik bëhet vetëm në mënyrë:

1.5 SASIA E SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME TË GRUMBULLUARA SIPAS KATEGORISË

KIMIKATET	SASIA NË TON
SHUMË TOKSIKE	40
TOKSIKE	575
EKSTREMISHT TË DJEGSHME	110
OKSIDUESE	330
TË DËMSHME PËR SHËNDETIN	300
IRRITUESE	12
TË TJERA	164
TOTALI	1.531

1.5.1 PËRSHKRIMI I ZONAVE PROBLEMATIKE

Natyra e Problemit	Qyteti/Rajoni	Përshkrim i Prob.	Kimikatet/Ndotësi
Ndotja e ajrit	Tiranë,Durrës,	Transp.Automobili. Ndërtimet, Industritë	NOx,Sox,CO2,PM10
	Fier,Marins ,Ballsh,Patos	Ndotja nga hidrkarburet, Ind. E plehrave azotike	SO2 , CO2 , As ,
	Elbasan	Fab.Çimentos,Metalurgji	PM10,SO2.CO2,NOx
	Vlora,	Ndotja nga zhiva	
	Laç	Industria e plehrave fosforike dhe ac.sulfurik	V2O5
	Durrësi	Ndotja nga kromatet dhe pesticidet, përpunimi i lëkurave	Cr , pesticide
	Rubik	Ind.bakrit dhe pasurimit të mineraleve	Bari, mikroelemente

1.5.2 SHQETËSIMET PRIORITARE NË LIDHJE ME KIMIKATET

Natyra e Problemit	Shkalla e Problemit	Niveli i Shqetësimit	Mundësia kontrollit të problemit	Disponim i të dhënave statistikor	Kimikate të veçanta që shkaktojnë probleme	Prioriteti
Ndotja e Ajrit	Kombëtar	Lartë	Mesatar	I Pamjaftu Eshëm	PM10,PM2.5 SO2.CO2, NOx	Lëvizja e kontrolluar makinave Ndërtimet me kriter
Ndotja e Lumenjve	Kombëtar	Lartë	Mesatar		NH3,NO2,N O3,P, COD,BOD5	Kontrolli i shkarkimeve në lumenj vendosja e impianteve të pastrimit
Ndotja e ujrave Tokësore	Kombëtar	Lartë	Mesatar		Shkarkimet urbane	Kontrolli i shkarkimeve, vendosja e impianteve të pastrimit
Ndotja e tokës	Kombëtar	Lartë	Mesatar		Industria , ndërtimi	Kontrolli ë shkarkimeve, vendosja e impianteve të pastrimit
Ndotja nga Mbetjet kimike në ushqime	Kombëtar	Lartë	Mesatar		Metalet e rënda Pesticidet	Kontrolli i përdorimit të pesticideve dhe teknologjive

2. KUADRI LIGJOR LIDHUR ME KIMIKATET

2.1 OBJEKTIVI POLITIK

Menaxhimi i qëndrueshëm i kimikateve, përveçse një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit, përbën dhe një nga objektivat e qeverisë shqiptare, përfshirë edhe në Programin e saj 2005-2009. Objektivi synon në stimulimin e zhvillimit të teknologjive të pastra, të cilat përveç të tjerave duhet të përdorin lëndë kimike të çertifikuara në mënyrë që të pakësojnë shkarkimet e dëmshme në mjedis (ujë, ajër, tokë, etj).

Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me qëllim nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për fushën e mjedisit (neni 108 MSA)/(PLANI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT, 2007-2012)

Legjislacioni lidhur me substancat kimike në Republikën e Shqipërisë rregullon menaxhimin e substancave dhe preparateve kimike, substancat për mbrojtjen e bimëve, lëndëve eksplozive, lëndëve të gazta dhe të lëngëta që marrin flakë, substancave të rrezikshme, substancave ozonholluese, ndotësit organikë të qëndrueshëm etj.

Në Republikën e Shqipërisë, ligji bazë që rregullon administrimin e substancave dhe preparateve kimike është ligji nr.9108, datë 17.7. 2003 për “Substancat dhe Preparatet Kimike”, botuar Fletorja zyrtare Nr 66, Viti 2003, faqe 2925, data e botimit 04.08.2003. Ligji 9108/03 transponon pjesërisht (70%) Direktivën e Këshillit 76/769/EEC e datës 27 Korrik 1976 mbi përafrimin e legjislacionit, rregullave dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me ndalimin e shitjeve dhe përdorimin e disa substancave e preparateve të rrezikshme, 31976L0769, Gazeta Zyrtare 262, seria L e datës 17 shtator 1976, fq. 0201 – 0203

Ky ligj ka për objekt të tij vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve të personave juridikë ose fizikë, në përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe



tregëtimin e tyre. Ligji 9108/03 parashikon rregulla për klasifikimin dhe testimin e substancave dhe preparateve kimike para se ato të hidhen në treg. Sipas këtij ligji testimi duhet të bëhet me metoda që plotësojnë parimet e mbrojtjes së kafshëve eksperimentale të cilat vendosen me urdhër nga Ministritë kompetente. Sipas këtij ligji Ministria e Mjedisit mban Regjistrin Kombëtar për substancat dhe preparatet kimike dhe të dhënat për këtë regjistër sigurohen nga ministritë e ngarkuara nga ky ligj.

Në zbatim të ligjit 9108/03 Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 824, datë 11.12.2003 "Për klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme, e cila transponon pjesërisht (70%), Direktivën e Këshillit 67/548/EEC e datës 27 Qershor 1967 mbi përafrimin e legjislacionit, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme, 31967L 0548, Gazeta Zyrtare 196, seria L e datës 16 gusht 1967, fq. 0001 - 0098.

VKM Nr.824, datë 11.12.2003 "Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme", Fletorja Zyrtare Nr 106, Viti 2003, faqe 4543, data e botimit 31.12.2003, ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe rregullat ndërkombëtare.

Gjithashtu VKM 824/03 përcakton parimet e klasifikimit të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar dhe përshtat udhëzimet e fundit të Komitetit Europian për ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme.

Sipas pikës 7.10 të këtij Vendimi depozitimi dhe ruajtja e kimikateve të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin i nënshtrohet procedurës së lejes dhe regjistrimit. Aplikimet për leje i drejtohen Ministrisë së Ekonomisë Tregëtisë dhe të Energjitikës, ndërsa për regjistrim, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës ngrihet komisioni për dhënien e lejes, për depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme me përfaqësues nga Ministria



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



e Industrisë dhe e Energjitikës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Mjedisit. Proçedura e marrjes së lejes dhe rregullorja e funksionimit të komisionit miratohen nga titullarët e ministrive të ngarkuara.

Rregullimi i veprimtarisë së importit, eksportit, tranzitit, transhipit të të gjithë kimikateve të përfshira në konventën kimike, bëhet me aktet normative të poshtëshënuara:

Ligji nr. 7747, datë 29.07.1993 “Për ratifikimin i konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre” (*Fletore zyrtare, viti 1993, nr 10, faqe 677, data e botimit 7.8.1993*).

Ligji nr. 9092, datë 03.07.2003 “Për zbatimin e Konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të Armëve Kimike dhe për shkatërrimin e tyre.” (*Fletore zyrtare, viti 2003, nr 63, faqe 2809, data e botimit 4.8.2003*),

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 22.01.2004. “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e bordit të këshilltarëve, për zbatimin e konventës kimike për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre”, (*Fletore zyrtare, viti 2004, nr 3, faqe 77, data e botimit 30.01.2004*).

Të gjithë kimikatet që përfshihen në konventën kimike të shkallës parë, dytë, tretë, paisjet e tjera prodhuese të kimikateve, të veçanta të cilat janë të kontrolluara sipas kësaj konvente, mund të inspektohen në çdo kohë nga Organizata e Ndalimit të Armëve Kimike, në zbatim të kuadrit ligjor të mësipërm. Gjithashtu kimikatet e mësipërme raportohen në Organizatën e Ndalimit të Armëve Kimike, ku kjo e fundit në çdo kohë mund të bëjë inspektimin e tyre.

Ligji Nr.8934, datë 5.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” është ligji bazë, i cili rregullon mardhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushtet për zhvillimin e qëndrueshëm. Ligji nuk rregullon direkt aktivitetet në lidhje me kimikatet, por indirekt dhe me të njëjtën përgjegjësi, ai duke iu përmbajtur qëllimit të tij në kapituj dhe nene të veçanta parandalon impaktet e tyre në mjedis që mund të vijnë nga keqadministrimi. Neni 2 i Ligjit shprehet: “Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë”... etj.

Ligji në kapituj të veçantë përmend Vlerësimin i Ndikimit në Mjedis (V.N.M). Lejen për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis, Parandalimin dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, Monitorimi dhe të dhënat, Kontrolli mjedisor, Detyrat e organeve shtetërore për mjedisin, Roli i publikut dhe Sanksionet. Megjithëse nuk përmend kimikatet në formulimet e neneve të këtyre kapitujve, ai mbron mjedisin nga ndikimi i tyre por njëkohësisht i hap rrugën zhvillimit të sigurtë të çdo veprimtarie qoftë edhe të rrezikshme për njeriun dhe mjedisin.

Duke kërkuar marrjen e një sërë masave nga subjektet që zhvillojnë aktivitetet dhe vendosur kompetencat e organeve shtetërore për parandalimin e impakteve në mjedis, Ligji me sanksionet që parashikon nuk lë mënjanë dhe veprimtaritë me kimikatet pa përjashtim. Ligji nr.9092, datë 3.07.2003 Për zbatimin e “Konventa për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre”. Ligji përcakton autoritetin, përgjegjësitë, krijimin dhe funksionimin e organeve të nevojshme për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga Konventa për Ndalimin e Armëve Kimike (KNAK) në ***Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri*** Republikë e Shqipërisë si shtet palë e saj. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti shtetëror i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Konventës. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Bordi i Këshilltarëve si organ këshillimor për çështjet e konventës, përbërja e të cilit propozohet nga ministri i Mbrojtjes dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Sipas neni 5 të këtij ligji “çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që prodhon, zotëron, përdor ose transferon lëndë kimike, importon dhe /ose eksporton lëndë me përbërje kimike të përcaktuara në tabelat 1,2 dhe 3 që i bashkëlidhen këtij ligji, si dhe zotëruesit e impianteve të prodhimit të këtyre lëndëve janë subjekt deklarimi dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror, për të siguruar përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me Konventën dhe me këtë ligj. ”Në ligj jepen rregullat për deklarim dhe marrejn e licencës. Në nenin 17 të ligjit thuhet “Në Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës krijohet dhe funksionon, si organ kontrolli, struktura e Inspektimit Shtetëror”.



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



Ligji Nr.8990, datë 23.01.2003 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” synon të sigurojë vlerësim të përgjithshëm dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis.(neni 1, pika 2). Këto projekte apo veprimtari që i nënshtrohen procesit të V.N.M jepen në shtojcat 1 dhe 2 te nenit 4 të këtij ligji. Përsa u përket prodhimit të kimikateve të ndryshme që i nënshtrohen V.N.M jepen në shtojcën 1, pika 22 nga gërma (a –dh) dhe pika 23,34,39,40 dhe 41.

Ligji përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të veprimtarisë në mjedisin ku zbatohen.

Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”, garanton të drejtën e shtetesave për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar. Ligji përcakton dhe klasifikon burimet e ndotjes, treguesit mjedisorë bazë të gjendjes së ajrit (përmbajtjes të lëndëve të ngurta, të oksidit të squfurit, të oksidit të karbonit, të ozonit, të plumbit/aerosol/ dhe oksideve të azotit). Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mjedisit miraton normat e përkohëshme të shkarkimeve në ajër, bazuar në normat e Bashkimit Evropian.

Në kapitullin e 4 të ligjit jepen detyrimet për mbrojtjen e ajrit për personat fizikë e juridikë ,si dhe detyrimet kryesore të operatorëve të burimeve të palëvizshëm të ndotjes. Normat e shkarkimeve nga burimet e lëvizëshme miratohen me udhëzim të përbashkët nga Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Transporteve.

Zonat me mbrojtje të veçantë shpallen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë. Për ndotjen e ajrit, operatorët e burimit të ndotjes paguajnë taksë shkarkimesh, sipas sasisë dhe tipit të ndotësive të shkarkuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”, ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësive të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës në tërësi nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Në nenin 6 të këtij akti, pika 2 gërma dh dhe g, pika 3 gërma d dhe neni 9 pika 2b ndalojnë përdorimin apo depozitimin e kimikateve të ndryshëm në Zonat e Mbrojtura (Parku Kombëtar)

Ligji Nr.9010, datë 13.02.2003 ‘Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta’

Synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Ligji nuk është i zbatueshëm sipas nenit 3 pika 2 për mbetjet e rrezikshme, radioaktive, bërthamore dhe eksplozive, administrimi i të cilave rregullohet me ligje të veçantë.

Sipas nenit 10 germa c zotëruesit e mbetjeve duhet të sigurojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme prej mbetjeve të tjera, dhe ruajtjen e sigurtë të mbetjeve, për të cilat nuk ekzistojnë mënyra të përshtatëshme përpunimi dhe asgjësimi. Në vijim të këtij neni gërma d zotëruesit e mbetjeve duhet të sigurojnë që grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme të bëhet i veçuar dhe ato të ruhen përkohësisht në mbajtës specialë paketohen, etiketohen dhe transportohen në përputhje me rregullat dhe standartet ndërkombetare të miratuara në Republikën e Shqipërisë. Shpenzimet për të gjitha këto përballohen nga zotëruesit e mbetjeve.

Sipas nenit 26 të këtij ligji, në Republikën e Shqipërisë ndalohet importimi i mbetjeve për ruajtje, depozitim ose asgjësim. Monitorimi i mbetjeve është pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe kryhet sipas kërkesave të tij. Inspektorati Bashkiak dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror kontrollojnë zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për krijimin, grumbullimin, ruajtjen, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve urbane, të mbetjeve të ndërtimit dhe të mbetjeve të vëllimshme. Inspektorati i Mjedisit kontrollon zbatimin e rregullave dhe të kërkesave të vendosura në Lejen Mjedisore të zotëruesit të mbetjeve.



Ligji Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura” ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura. Ligji në nenin 4 përcakton detyrat e Ministrisë së Mjedisit dhe të organeve shtetërore qendrore dhe vendore sipas linjës së vet që të bashkëpunojnë për:

- përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira për trajtimin e ujërave të ndotura;
- hartimin e planeve, krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, përsosjen e rrjetit institucional përgjegjës, sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare si dhe kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave dhe subjekteve të angazhuara për trajtimin e pastrimit të tyre.

Lidhur me ekzistencën e një regjistri zyrtar të kimikateve që gjenden në tregun shqiptar, mësohet se:

Në Republikën e Shqipërisë nuk ka akoma një regjistër të kimikateve që të plotësojë kërkesat e legjislacionit Evropian. Sipas ligjit nr.9108 datë 17.7.2003 për “Substancat dhe Preparatet Kimike”, prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme janë të detyruar të regjistrojnë llojin, sasinë, vetitë e substancës dhe të preparatit. Regjistrimi bëhet veçmas për çdo biznes. Mënyra dhe hollësitë e regjistrimit dhe të njoftimit përcaktohen nga zyra e regjistrimit të kimikateve.

Gjithashtu, prodhuesit dhe importuesit vetëm të substancave të rrezikshme ose që përmbahen në preparat në sasi më të madhe se 10 tonë për një vit kalendarik, janë të detyruar të njoftojnë me shkrim ministrinë përkatëse, 1 herë në vit për llojin e substancës së rrezikshme, që prodhojnë ose importojnë, sasinë dhe vetitë e saj.

Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar që për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të përcaktuara në ligjin 9108/03, të njoftojnë Agjencinë Rajonale të Mjedisit, të regjistrojnë hyrjet e këtyre substancave dhe sasinë maksimale të ruajtur. Agjencitë Rajonale të Mjedisit dhe njësitë vendore të mbrojtjes së shëndetit përcaktojnë kushtet speciale për kryerjen e aktiviteteve të cilat përdorin substanca të rrezikshme.



Ligji 9108/03, përcakton që me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave miraton listën e substancave dhe të preparateve kimike, prodhimi, hedhja në treg dhe përdorimi i të cilave kufizohen ose ndalohen.

Lidhur me identifikimin e substancave të reja kimike, Këshilli i Ministrave me anë të Vendimit nr. 100, datë 03.02.2008 “Për përcaktimin e substancave të rrezikshme”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 19 të nenit 2 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, miratoi listën me 220 substanca të rrezikshme.

3. RREGULLAT PËR KLASIFIKIMIN, PAKETIMIN DHE ETIKETIMIN E KIMIKATEVE (SI PËR SUBSTANCAT ASHTU DHE PËR PREPARATET)

Sipas nenit 7/4 të ligjit nr. 9108 datë 17.7.2003 për “Substancat dhe Preparatet Kimike”, procedurat për vlerësimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, mënyra e klasifikimit, ambalazhimit dhe etiketimit dhe lista e substancave të rrezikshme, që do të klasifikohen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregullat e klasifikimit të paketimit dhe etiketimit në Shqipëri përcaktohen në VKM Nr.824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”, vendim i cili është hartuar në përputhje me direktivën e BE, 67/548/EEC e datës 27 Qershor 1967 “Për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme”, 31967L0548, Gazeta Zyrtare 196, datë 16 Gusht 1967, fq. 1–98

VKM 824/03 synon, krijimin e kushteve të sigurta për administrimin e të gjitha kimikateve dhe preparateve kimike që importohen, eksportohen, prodhohen, tregëtohen, përdoren dhe ruhen në vendin tonë.

Sipas pikës 3 të Vendimit 824/03 klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme bëhet sipas Sistemit Ndërkombëtar, i cili bazohet në vetitë fiziko-kimike, toksikologjike dhe në bazë të efekteve të veçanta në shëndetin e njeriut dhe efektet në ndotjen e mjedisit. Në zbatim të ligjit "Për substancat dhe preparatet kimike",



vlerësimi i rrezikut të një kimikati ose të një preparati për shëndetin e njeriut bëhet me metodat tradicionale, duke përdorur përqëndrimet limite, individuale të preparatit.

Pika 4 e këtij Vendimi rregullon kërkesat që duhet të plotësojë prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi për ambalazhimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme si dhe jep instruksione për mënyrën e paketimit, materiali që duhet përdorur si dhe kushteve të izolimit. Kërkesat kanë lidhje me qëndrueshmërinë e ambalazhit, hermeticitetin dhe shenjat paralajmëruese të rrezikut të substancave dhe preparateve të rrezikshme.

Gjithashtu në këtë vendim (pika 5) jepen rregulla për etiketimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme, para se ato të hidhen në treg. Po ashtu është përcaktuar se çfarë duhet të përmbajë etiketa e ambalazhit të substancave të preparateve të rrezikshme të hedhura në treg si dhe jepen parashikime të veçanta në lidhje me etiketimin e disa preparateve të klasifikuara të rrezikshme për shitje publikut të gjerë.

Substancat dhe preparatet kimike sipas pikës 7 të VKM 824/03 ruhen të depozituara në magazina të përcaktuara për këtë qëllim dhe në kushte të veçanta.

Në anekset e këtij vendimi paraqiten lista e frazave standarte mbi natyrën e rreziqeve të veçanta nga substancat (R-phrases), rregullat e sigurisë nëpërmjet frazave e sigurisë (S-phrases) si dhe klasifikimi i substancave dhe preparateve kimike sipas numrit rendor të elementit Rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin datë 22.12.2008.

Më konkretisht në këtë VKM etiketat tregohen qartë dhe në mënyrë të pashujtshme të dhënat e përmbajtjes së saj, e cila detyrimisht është shqip; plotësimi dhe vendosja e saj mbi ambalazh; kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet që merren me ambalazhim të PMB-ve; detyrimet ligjore që kanë në aktivitetin e tyre si dhe të subjekteve tregëtuese të PMB-ve që kërkojnë të ambalazhojnë ata në Republikën e Shqipërisë.

Duke patur parasysh zhvillimet evropiane dhe ndërkombëtare lidhur me klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve, është e nevojshme të rishikohet legjislacioni aktual përkatës, bazuar në rregulloren (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve”, ose në Sistemin e Harmonizuar Globalisht për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve (GHS- Globally Harmonized System for Classification and Labelling of Chemicals).



Në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA 2009-2014 për adresimin e prioriteteve afatgjata është parashikuar hartimi i disa akteve ligjore që synojnë transpozimin e pjesëshëm të direktivave përkatëse të kimikateve.

4.1 PROCEDURA PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE DHE VLERËSIMIN E RREZIQEVE PËR KIMIKATET

Neni 13 i ligjit nr. 9108 datë 17.7. 2003 për “Substancat dhe Preparatet Kimike”, parashikon vlerësimin e riskut të substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Lista e substancave të rrezikshme, që prej natyrës së tyre përbëjnë një rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministria e Mjedisit, së bashku me ministrinë e tjera të ngarkuara nga ky ligj, marrin masa për vlerësimin e riskut për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin për substancat e përfshira në listë. Procedurat për vlerësimin e riskut të substancave të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, ndërsa procedurat për vlerësimin e riskut të substancave të rrezikshme për mjedisin përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mjedisit.

Në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut të substancave të rrezikshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës, vendos kushtet për hedhjen e këtyre substancave në treg.

Studimi i vitit 2008 i Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikë (METE) “Trajtimi i kimikateve të rrezikshme, gjendje në ndërmarrjet dhe shoqëritë, në varësi të METE ” ka evidentuar dhe përditësuar situatën në lidhje me gjendjen e kimikateve të rrezikshme në depot e shoqërive, ndërmarrjeve dhe institucioneve të industrisë jo ushqimore. Gjithashtu në studim janë përcaktuar edhe opsionet për eliminimin e tyre, me kostot përkatëse, për t'i bërë ato të parrezikshme për ambientin dhe banorët e zonave ku janë depozituar.

Në kuadër të Programit të UNDP për pikat e nxehta mjedisore është duke u zhvilluar projekti “ Identifikimi dhe Prioritizimi i Hot-spotëve ne Shqipëri”. Projekti ka kryer inventarin paraprak të 35 pikave të nxehta të identifikuara nga MMPAU. Për 10 pikat



e nxehta më prioritare po zhvillohet një studim i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili do të japë në mënyrë më të detajuar inventarin për këto pika të nxehta.

4.2 DISPOZITA LIGJORE, MASA ADMINISTRATIVE, SI DHE INFRASTRUKTURA PËRKATËSE PËR NDALIMIN DHE KONTROLLIN E EKSPORTIT DHE IMPORTIT TË DISA KIMIKATEVE TË RREZIKSHME DHE/OSE TË NDALUARA.

Legjislacioni shqiptar ka parashikime lidhur me ndalimin dhe kontrollin e import-eksportit të kimikateve të caktuara të rrezikshme. Ligji Nr.9108, datë 17.07.2003 “Për Substancat dhe Preparatet Kimike”, në kreun 7 trajton importin dhe eksportin e substancave dhe preparateve të rrezikshme, kushtet që duhet të plotësojnë importuesit dhe eksportuesit e këtyre substancave dhe nevoja për aplikim dhe miratim nga ministrinë kompetente.

Sipas nenit 21 të ligjit 9108/03, importi dhe eksporti i substancave dhe i preparateve të rrezikshme bëhen vetëm me leje të ministrisë përkatëse. Zyra e Regjistrimit të Kimikateve, në bazë të të dhënave të ministrisë të ngarkuara nga ky ligj, duhet të regjistrojë aplikimet për importin dhe eksportin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të caktuara, miratimet e dhëna, si dhe të njoftojë Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave për këto substanca.

Eksportuesi është i detyruar të vendosë mbi ambalazhin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të caktuara për veprimtari tregtare, etiketat në gjuhën e vendit pritës ose të zonës, ku këto substanca e preparate do të përdoren. Importuesit dhe eksportuesit janë të detyruar t’u paraqesin autoriteteve doganore, për kontroll, dokumentet shoqëruese të substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të caktuara për veprimtari tregtare.

Sipas nenit 22 të ligjit 9108/03, prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme janë të detyruar të regjistrojnë llojin, sasinë, vetitë e substancës dhe të preparatit. Regjistrimi bëhet veçmas për çdo biznes. Prodhuesit dhe importuesit vetëm të substancave të rrezikshme janë të detyruar të njoftojnë me



shkrim ministrinë përkatëse, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, për llojin e substancës së rrezikshme, që prodhojnë ose importojnë, sasinë dhe vetitë e saj.

Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar që për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të njoftojnë Agjencinë Rajonale të Mjedisit, të regjistrojnë hyrjet e këtyre substancave dhe sasinë maksimale të ruajtur. Gjithashtu, ata duhet t'i dërgojnë kësaj agjencie rregulloren e sigurimit teknik për këto substanca. Agjencia Rajonale e Mjedisit së bashku me njësinë vendore të mbrojtjes së shëndetit përcaktojnë, 24 orë para fillimit të veprimtarisë, për të cilin është bërë njoftimi, kushtet e veçanta për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Lidhur me infrastrukturën përkatëse për të ndaluar dhe kontrolluar eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme të caktuara dhe/ose të ndaluara, duke përfshirë pesticidet:

1. Autoritetet doganore kontrollojnë në pikat e kalimit të kufirit shtetëror mallin e deklaruar si substancë dhe preparat i rrezikshëm, për importin dhe eksportin e të cilave kërkohet miratim nga ministria përkatëse e përcaktuar nga ky ligj.

- Në rast dyshimi apo shkeljeje të këtij ligji, autoritetet doganore bllokojnë mallin dhe njoftojnë Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit ose Inspektoratin Sanitar Shtetëror për kundërvajtjen dhe, në rast dyshimi, u kërkojnë këtyre inspektorateve asistencë teknike.

- Autoritetet doganore regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe preparate të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror.

- Autoritetet doganore u lejojnë punonjësve të Ministrisë së Mjedisit dhe të inspektorateve shqyrtimin e regjistrave, në kopje të shkruara ose fotokopje, si dhe transmetimin dixhital të të dhënave.

2. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit bashkëpunon me autoritetet doganore dhe u siguron atyre asistencë me specialistë.

3. Inspektorati Sanitar Shtetëror bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe me autoritetet doganore, si dhe u siguron atyre asistencë me specialistë.

5. LODRAT DHE KUADRI LIGJOR

5.1 OBJEKTIVI POLITIK

Në zbatim të nenit 75 të MSA-së synohet nxitja e përdorimit të rregullave teknike të Komunitetit, Standardeve Europiane dhe procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë. Objektivi politik i strategjisë kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut është të garantojë vendosjen apo qarkullimin në treg vetëm të produkteve dhe shërbimeve të sigurta.

5.2 SITUATA AKTUALE

5.2.1 KUADRI LIGJOR EKZISTUES

Ligjet që nuk transpozojnë aktet komunitare dhe përputhshmëria e tyre:

Ligji Nr. 9097, datë. 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit”.

VKM Nr. 723, datë. 5.11.2004 “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”.

Sipas Vendimit Nr. 888, datë 19.12.2007, “ Për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave”, janë përcaktuar me detaje rregullat teknike, të cilat janë:

5.2.2 DJEGSHMËRIA

a) Lodra nuk duhet të përbëjë një element të djegshëm të rrezikshëm në ambientin e fëmijës. Për këtë qëllim, ajo duhet të përbëhet nga materiale që:

- nuk digjen me ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj flakës, shkëndijave ose një bartësi të mundshëm të zjarrit; ose
- nuk marrin flakë menjëherë (flaka shuhet sapo të zhduket shkaku i zjarrit); ose
- në rast se ndizen, të digjen ngadalë dhe të paraqesin një shkallë të ulët të përhapjes së zjarrit; ose
- pavarësisht nga përbërja kimike e lodrave, trajtohen në mënyrë të tillë që të vonojnë procesin e djegies.



Këto materiale të djegshme nuk duhet të përbëjnë rrezik ndezjeje për materiale të tjera të përdorura në lodër.

b) Lodra që, për arsye themelore të funksionimit të tyre, përmban lëndë ose preparate të rrezikshme, siç përkufizohen në ligjin nr.9108, datë 17.7.2003 “Për substancat e rrezikshme”, në veçanti materialet dhe pajisjet për eksperimente kimike, montime modeli, kallëpe plastike ose qeramike, emalim, fotografi ose veprimtari të ngjashme, nuk duhet të përmbajë substanca ose preparate që mund të bëhen të djegshme për shkak të humbjes së përbërësve fluororë të padjegshëm.

c) Lodra nuk duhet të jetë eksplozive ose të përmbajë elemente apo substanca që mund të shpërthejnë, kur përdoret siç është specifikuar në pikën 3.

d) Lodra dhe, në veçanti, lojërat dhe lodrat kimike, nuk duhet të përmbajnë lëndë ose preparate të tilla që, kur përzihen mund të shpërthejnë:

- përmes reaksioneve kimike ose nxehjes;

- kur përzihen me lëndë oksiduese;

ose përmbajnë elemente përbërëse fluore që digjen në ajër dhe mund të formojnë përzierje ajër/avull të djegshme ose shpërthyese.

5.2.3 VETITË KIMIKE

a) Lodra duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që, kur përdoret siç specifikohet në pikën 3 të rregullit teknik, ajo të mos paraqesë rreziqe për shëndetin ose rreziqe për dëmtim fizik përmes gëlltitjes, frymëmarrjes ose kontaktit me lëkurën, me indet mukoze ose sytë.

Në të gjitha rastet ato duhet të përputhen me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë, që ka të bëjë me kategori të caktuara produktesh ose me ndalimin, kufizimin e përdorimit ose etiketimin e disa lëndëve dhe preparateve të rrezikshme.

b) Në veçanti, për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, biodisponibiliteti që rrjedh nga përdorimi i lodrës, si objektiv nuk duhet t'i kalojë nivelet e mëposhtme në ditë:

0,2 µg për antimonin

0,1 µg për arsenikun

25,0 µg për bariumin

0,6 µg për kadmiumin

0,3 µg për kromin

0,7 µg për plumbin

0,5 µg për mërkurin

5,0 µg për seleniumin

ose vlera të tjera të tilla që mund të caktohen për këto lëndë ose të tjera në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë mbi bazën e provave shkencore.

Biodisponibiliteti i këtyre lëndëve do të thotë që ekstrakti i tretshëm ka rëndësi toksikologjike.

c) Lodra nuk duhet të përmbajë lëndë ose preparate të rrezikshme brenda kuptimit të ligjit nr.9107, datë 17.7.2003 “Për substancat e rrezikshme”, në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e fëmijëve që i përdorin ato. Në të gjitha rastet, është rreptësisht e ndaluar që në një lodër të përfshihen lëndë ose preparate të rrezikshme në rast se ato destinohen të përdoren si të tilla gjatë përdorimit të lodrës.

Megjithatë kur një numër i kufizuar lëndësh ose preparatesh janë themelore për funksionimin e një lodre të caktuar, në veçanti, të materialeve dhe pajisjeve për eksperimente kimike, montim modeli, kallëpe plastike ose qeramike, emalim, fotografi ose veprimtari të tjera të ngjashme, ato lejohen deri në një nivel maksimal përqendrimi, me kusht që lëndët dhe preparatet e lejuara të jenë në konformitet me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe preparateve të rrezikshme” në lidhje me etiketimin, pa paragjykuar pikën 26(d).

d) Lodra që përmban lëndë ose preparate qenësisht të rrezikshme. Lodra kimike.

- Pa paragjykuar zbatimin e dispozitave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.824, datë 11.12.2003 “Mbi klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin dhe ruajtjen e substancave ose preparateve të rrezikshme”, udhëzimet për përdorimin e lodrave që përmbajnë lëndë ose preparate qenësisht të rrezikshme, duhet të përmbajnë një paralajmërim për natyrën e rrezikut të këtyre lëndëve ose preparateve, dhe një tregues të masave paraprake të specifikuara saktësisht sipas tipit të lodrës që duhet të merren nga përdoruesi, me qëllim që të shmangen rreziqet që e shoqërojnë. Duhet të përmendet edhe ndihma e parë që duhet të jepet në rast aksidentesh të rënda



si rezultat i përdorimit të kësaj lodre. Duhet të theksohet gjithashtu që lodrat të mbahen larg fëmijëve shumë të vegjël.

- Krahas udhëzimeve të parashikuara në (a), lodrat kimike duhet të mbajnë në ambalazhin e tyre këtë shënim:

“Kujdes! Vetëm për fëmijët mbi (mosha vendoset nga prodhuesi) vjeç. Për përdorim nën mbikëqyrjen e të rriturve”.

Në veçanti, këto lodra konsiderohen si lodra kimike: komplete kimike, komplete plastike, reparte në miniaturë për punim qeramike, emalim, fotografi dhe lodra të ngjashme.

6. SITUATA NË TERREN

Shqetësimi mbi importin e lodrave toksike apo të pasigurta, si dhe sendeve të ndryshme nga Kina është bërë tashmë pjesë e Parlamentit Evropian. Aktualisht gjysma e alarmeve për prodhime të pasigurta lidhen me prodhimet kineze. Lodrat e sigurta kanë një stampë ku shkruhet se, janë prodhuar sipas udhëzimeve të Bashkimit Evropian dhe nuk përmbajnë lëndë toksike ose të papërshtatshme dhe kanë shenjën CE. Por fatkeqësisht kjo shenjë qarkullon në përmasa dhe stile të ndryshme duke bërë dhe falsifikim të saj jo vetëm në vend, por dhe në vendet e BE. Shumë prej lodrave që tregtohen në vend janë të rrezikshme për shëndetin e fëmijëve, pasi kanë përmbajtje të lartë kimikatesh. Alarmi vjen nga Ministria e Ekonomisë. Konkretisht bëhet fjalë për disa lodra të kompanisë "Fisher Price", e cila ka kërkuar vetë tërheqjen nga tregu të një kategorie lodrash të prodhuara prej saj, që paraqesin rrezikshmëri për përmbajtjen e plumbit mbi nivelet e lejuara. Por nuk përfundon me kaq. Përveç këtyre, rrezikshmëri të lartë ndaj shëndetit të fëmijëve paraqesin edhe lodrat e importuara nga Kina. Konkretisht lodrat e prodhuara në Kinë paraqesin rrezikshmëri të lartë ndaj mbytjes ose helmimit, shokut elektrik, dëmtimeve të ndryshme fizike apo bakteriologjike etj., të provuara nga testimet e laboratorëve të akredituar në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian. Në këto kushte, Ministria e Ekonomisë u ka bërë thirrje të gjithë konsumatorëve që të mos blejnë këto kategori lodrash. Nga ana tjetër,



ajo u ka kërkuar të gjithë tregtarëve që të mos tregtojnë lodrat e prodhuara nga kjo firmë, si edhe produktet e importuara nga Kina. Lista e lodrave të rrezikshme është e gjatë, duke filluar që nga makina për fëmijë, kukullat etj. Ndërkohë do të jetë Inspektorati Qendror Teknik ai që do merret me ndalimin e tregtimit të këtyre lodrave të treg. Në një prononcim për gazetën "Panorama", kryetari i këtij inspektorati, Ilir Kurti, është shprehur se aksioni për evidentimin e pikave që tregtojnë këto lodra ka nisur që ditën e hënë. Sipas tij, pika kryesore nga tregtohet kjo kategori mallrash është Medreseja, ose siç njihet ndryshe tregu kinez. Por këto lodra nuk tregtohen vetëm këtu. "Ka edhe shumë individë të palicencuar, të cilët shesin lodra në mes të rrugës", tha Kurti. Në këto kushte, ai u bën thirrje të gjithë qytetarëve që të mos blejnë lodrat që tregtohen nëpër rrugët e qytetit, pasi edhe këto lodra janë të importuara nga Kina dhe, për pasojë kanë përmbajtje të lartë kimikatesh. Deri më tani inspektorët e këtij inspektorati kanë arritur të piketojnë të gjitha pikat ku tregtohet kjo kategori malli. "Të premtën do të dalë edhe urdhri i bllokimit të këtyre lodrave të rrezikshme", theksoi Kurti. Në fakt, sipas tij, nuk është ky problemi i vetëm. Sipas tij, inspektorati do të largojë nga tregu edhe revolet me saçme siç njihen nga fëmijët, pasi sipas kryeinspektorit këto lodra janë të rrezikshme për fëmijët. Përveç këtyre ka edhe mjaft pajisje elektrike, të cilat kanë një cilësi mjaft të dobët dhe, për rrjedhojë, nuk do të lejohen që të tregtohen më në tregjet e vendit.

RASTI 1

Nga ana e Inspektoratit janë sekuestruar në vitin 2010 rreth 890 copë lodra plastike që shiteshin në tregjet shqiptare, për shkak të përqindjes së lartë të plumbit dhe lëndës helmuese që ato përmbanin. Në fund të vitit të shkuar, Ministria e Ekonomisë njoftoi se një kategori lodrash të kompanisë "Fisher Price" paraqisnin rrezikshmëri për përmbajtjen e plumbit mbi nivelet e lejuara. Sipas ministrisë, kjo shoqëri ka kërkuar vetë tërheqjen e këtyre lodrave. Nga ana tjetër, në kuadër të Sistemit për Këmbimin e Shpejtë të informacioneve për produktet e rrezikshme të vendosura në tregun e brendshëm të BE-së, Ministria e Ekonomisë informoi për një kategori tjetër lodrash të



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



rrezikshme. Bëhej fjalë për lodra të tjera që vijnë kryesisht nga Kina, të cilat paraqisnin rrezikshmëri të lartë ndaj asfiksimit ose helmimit, shokut elektrik, dëmtimeve të ndryshme fizike apo bakteriologjike të provuara nga testimet e laboratorëve të vendeve të BE-së.

Apeli për kujdes

Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për marrjen e të gjitha masave për të garantuar sigurinë e produkteve joushqimore në treg, si dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Ajo tërheq në vazhdim vëmendjen jo vetëm të konsumatorëve për mosblerjen e tyre, por edhe të shitësve të pakicës dhe shumicës për ndalimin e tregtimit të kësaj kategorie lodrash. Gjatë asaj periudhe nga ana e Ministrisë u morën masa për koordinimin me sukses të këtij aksioni me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për pezullimin e zhdoganimeve, si dhe me IQT-në për ndalimin e tregtimit të mëtejshëm të tyre. Përveç sekuestreimeve, nga ana e inspektorëve të IQT-së do të vendosen gjoba, vlera e të cilave varion nga 200 mijë në 600 mijë lekë. Po ashtu, subjektet do të gjobiten me 200 mijë lekë në rast se ata nuk pranojnë t'u paraqesin inspektorëve dokumentacionin e nevojshëm për verifikim. Kontrollat parashikohet të kryhen për të gjitha kategoritë e këtyre produkteve, ku në mjaft raste do të rishikohet përqasja e kontrollit.

RASTI 2

30 Dhjetor 2008

Një aksion i pazakontë kundrejt lodrave për fëmijë është ndërmarrë gjatë ditës së djeshme në Tiranë, nga Inspektorati Qendror Teknik (IQK). Inspektorati ka bllokuar në kryeqytet rreth 300 lodra plastike, imitime frutash, të cilat kanë rezultuar të mbushura me lëndë të ndryshme, të dëmshme për shëndetin. Drejtori i Inspektoratit Qendror Teknik, Ilir Kurti i ka bërë dje thirrje konsumatorëve, që mos të blejnë lodra që shiten në rrugë e trotuare, pasi ato tregtohen jashtë normave dhe kontrollit. "Lodrat plastike ishin të mbushura me pluhur, ose bojë dhe tregëtoheshin nga shitësit ambulantë për fëmijët afër shkollave, në rrugë e trotuare", tha Kurti. Drejtori i IQK-



së, Ilir Kurti, shtoi se për këtë problem, është vendosur edhe një numër telefoni, ku qytetarët mund të denoncojnë rastet e tregëtimit të këtyre lodrave të rrezikshme për shëndetin. Sipas tij, aktualisht po hetohet lidhur me prejardhjen e këtyre lodrave dhe subjektin që i ka sjellë në Shqipëri. Në fakt, megjithëse qytetarët e dinë fare mirë se në Shqipëri kanë ardhur lodra të rrezikshme, ata vazhdojnë t'i kërkojnë. Shitësit rrëfejnë se edhe prindërit pyesin për këto lloj lodrash, edhe pse e dinë se dëmtojnë shëndetin. Megjithatë, ka edhe një pjesë tjetër e cila është ndërgjegjësuar në lidhje me pasojat që bartin me vete këto lodra nëse përdoren. Kjo kategori arrin t'i rezistojë fëmijeve të tyre, duke i shmangur nga dyqanet që kanë lodra të tilla. Ata detyrohen t'u blejnë makina, edhe pse kushtojnë shumë më shtrenjtë, vetëm e vetëm që të shmangin ato me përberje helmesh apo radioaktiviteti. Megjithatë duket se fluksi i blerjes së lodrave ka rënë ndjeshëm në krahasim me vitet e kaluara. Sipas tregtarëve, xhiroja ka qenë shumë më e madhe për shkak të shumëllojshmërisë së blerjeve. Ndërsa sivjet, prindërit mjaftohen vetëm me një lloj lodre.

(Materialet e sipërsënuara kanë qarkulluar në të gjitha mediat e shkruara)

7. MBROJTJA E KONSUMATORIT.

LIGJET PËRKATËSE.

Ligji nr.8531,dt.23.09.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”, Fletorja zyrtare Nr 27, Viti 1999, faqe 1035, data e botimit 22.10.1999, rregullon kontrollin e plehrave kimike, të importit dhe të vendit, që qarkullojnë në tregun shqiptar, për të siguruar përdorimin e plehrave të sigurt e cilësore, në përputhje me kërkesat për ruajtjen e shëndetit të njerëzve, të kafshëve, të bimëve për mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit.

7.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR MENAXHIMIN E SUBSTANCAVE DHE TË PREPARATEVE TË RREZIKSHME

I. Neni 14 i Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003

Për substancat dhe preparatet kimike



1. Në menaxhimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme çdo person është i detyruar të ruajë shëndetin e njeriut dhe mjedisin, të vendosë shenjat paralajmëruese të rrezikut, me shprehjet që përshkruajnë rrezikun specifik dhe me udhëzimet e sigurimit teknik për menaxhimin e tyre.

2. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, mund t'i menaxhojnë substancat dhe preparatet e rrezikshme, që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme, sipas pikave 1, 2, 3, 6, 12, 13, 14 dhe 15 të nenit 5 të këtij ligji dhe t' i trajtojnë këto substanca në sasi më të madhe se 10 tonë për një vit kalendarik, vetëm me leje të ministrisë përkatëse.

3. Menaxhimi i substancave të rrezikshme bëhet pasi është marrë leja nga agjencia rajonale e mjedisit.

4. Personat fizikë mbi moshën 18 vjeç dhe me zotësi juridike për të vepruar, mund të menaxhojnë substancat dhe preparatet e klasifikuara sipas pikave 6, 7, 9, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji.

5. Personat fizikë nga 15 deri në 18 vjeç mund të menaxhojnë substancat dhe preparatet e klasifikuara sipas pikave 6, 7, 9, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji, vetëm në kuadër të përgatitjes profesionale dhe nën mbikëqyrjen e një personi me kualifikim profesional, sipas pikës 2 të nenit 19 të këtij ligji.

6. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar të lejojnë personat e autorizuar nga zyrat e kontrollit dhe të inspektimit, të hyjnë në mjediset dhe ndërtesat, që përdoren për menaxhimin e substancave dhe të preparateve dhe të marrin të gjitha të dhënat e nevojshme për punën e tyre.

II. Neni 15 i Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike"

1. Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi nuk lejohen të hedhin në treg substancat dhe preparatet e rrezikshme, të përfshira në aneksin nr. 2 të këtij ligji.



2. Me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave miraton listën e substancave dhe të preparateve kimike, prodhimi, hedhja në treg dhe përdorimi i të cilave kufizohen ose ndalohen.

III. Neni 16 i Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike”

1. Personi juridik ose fizik *nuk mund t’u shesë konsumatorëve ose t’i japë një personi tjetër, që nuk ka lidhje me veprimtarinë tregtare, substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 12, 13 dhe 14 të nenit 5 të këtij ligji.*

2. *Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, nuk lejohen t’u shesin konsumatorëve ose t’i japin një personi tjetër substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 5 të këtij ligji:*

a) personave nën moshën 18 vjeç;

b) personave që u është hequr ose kufizuar zotësia juridike për të vepruar.

3. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare nuk lejohen të shesin substanca dhe preparate të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 5 të këtij ligji, *në vendqëndrime, në lëvizje, në makina automatike për shitje dhe në kontenierë, të caktuar nga blerësi.*

4. Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar që për shitjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të klasifikuara sipas pikave 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 5 të këtij ligji, të sigurojnë vendosjen më vete të këtyre substancave dhe preparateve nga mallrat e tjera. Këto substanca dhe preparate duhet të mbahen vetëm në ambalazhe origjinale, të mbyllura dhe të pathyeshme. Në rastet e shitjes me vetëshërbim, këto mallra nuk lejohen të ekspozohen në vende ku mund të merren lirisht, ato duhet të jepen vetëm nga shitësi.

7.2 AMBALAZHIMI I SUBSTANCAVE DHE I PREPARATEVE TË RREZIKSHME PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT.

Në bazë të vendimit Nr. 824, datë 11.12.2003 *“Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”*

Klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme bëhet sipas Sistemit ndërkombëtar, i cili bazohet në vetitë fiziko-kimike, toksikologjike, efektet specifike në shëndetin e njeriut, efektet në ndotjen e mjedisit.

1. Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme mund t'i hedhë në treg ato, nëse siguron që nga ambalazhimi i substancës dhe i preparatit të rrezikshëm këto rrjedhin dhe nuk përbëjnë rrezik për dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mjedisit.

2. Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe i preparateve të rrezikshme për ambalazhet që përdor duhet të ketë parasysh këto kërkesa:

a) Ambalazhi të jetë i ndërtuar në mënyrë të tillë që përmbajtja të mos rrjedhë spontanisht.

b) Materiali përbërës i ambalazhit dhe mbyllësat të mos ndikohen nga përmbajtja e ambalazhuar dhe të mos formojë komponime të rrezikshme me këtë përmbajtje.

c) Në kushte normale pune, ambalazhi të jetë rezistent ndaj dëmtimeve dhe të jetë i siguruar që të mos ndodhin zërthime spontane të mbyllësve.

ç) Mbyllësat që përdoren në mënyrë të përsëritur të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që pas hapjes të mbyllen dhe të sigurojnë që përmbajtja e ambalazhit të mos rrjedhë.

d) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të etiketuara si shumë helmuese, helmuese, korrozive të destinuara për shitje me pakicë, të pajisen me mbyllësa rezistues, që të mos hapen nga fëmijët.

dh) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të etiketuara si të dëmshme për shëndetin, ekstremisht të ndezshme, shumë të ndezshme, të destinuara për shitje me pakicë, të pajisen me paralajmërues të prekshëm nga të verbërit.

e) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të ndryshojnë nga ambalazhet që përdoren normalisht për ushqimet, ujin e pijshëm, produktet mjekësore.

ë) Ambalazhet e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, të ofruar për shitje publikut të gjerë, nuk duhet të kenë:

- formë ose dekoracione që tërheqin a nxitin kuriozitetin e fëmijëve dhe të konsumatorëve të paorientuar;
- paraqitje ose vizatim, të përdorura për produkte ushqimore që përdoren për njerëzit, kafshët, produkte mjekësore ose kozmetike.

3. Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi i substancave dhe të preparateve të rrezikshme të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që ambalazhet të cilët mbajnë këto materiale, të ofruar për shitje publikut të gjerë, të jenë të pajisura me shenja të dukshme, paralajmëruese për rrezikun.

7.3 RUAJTJA E SUBSTANCAVE DHE PREPARATEVE KIMIKE

1 Substancat dhe preparatet kimike ruhen të depozituara në magazina të përcaktuara për këtë qëllim dhe në kushte të veçanta. Godina dhe instalimet e magazinës duhet të projektohen, dimensionohen dhe ndërtohen duke marrë parasysh vetitë e kimikateve për të parandaluar rrezikun për aksidente.

2 Magazina e ruajtjes së kimikateve duhet të vendoset në largësi të mjaftueshme nga qendrat e populluara, shkollat, institucionet e kujdesit, qendrat industriale, rrugëve me shumë trafik dhe zonat e rëndësishme për mjedisin.

Magazina e ruajtjes së kimikateve, pa arsye të justifikuara, nuk mund të vendoset në një zonë kryesore ose zona të tjera ujërash nëntokësore, të përshtatshme për furnizim me ujë. Në rast se një magazinë e kimikateve është e vendosur në një zonë të tillë, merren masa të veçanta, strukturore dhe operative, për të siguruar që veprimet në magazinë ose jashtë magazinës nuk sjellin rrezik për njerëzit, mjedisin ose pronën, në rast aksidenti ose avarie.

3 Magazina e ruajtjes të substancave dhe preparateve kimike duhet të ketë ajrim natyral dhe artificial, të jetë e mbrojtur nga rrufetë, të ketë kanalizime të ujërave dhe ujë të rrjedhshëm për larjen e duarve.

Magazina duhet të ketë këto pajisje:

- dollape, raftë, shtresa dërrase, shkallë, tryezë dhe karrige për kryerjen e punës, gjatë kontrollit të materialeve;
- instrumente dhe pajisje pune për shërbime teknike;
- aparaturë matëse dozimetrike dhe mjete të mbrojtjes kundërkimike;
- mjete zjarrfikëse dhe të ndihmës së parë;
- udhëzues për personelin e depos për masat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri.

7.4 RUAJTJA E SUBSTANCAVE DHE PREPARATEVE KIMIKE

1. Substancat shumë toksike dhe toksike ruhen në depo të veçanta, të ndara nga substancat dhe preparatet e tjera. Ato vendosen të ambalazuara mirë mbi zgara dërrase ose dollape (kur janë në ambalazhe të vogla), të mbyllura dhe siguruara mirë me çelës dhe vulën e dyllit.
2. Substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme, të depozituara në magazina të përcaktuara dhe kushte të veçanta, duhet të jenë të ambalazuara dhe etiketuara me simbolin e rrezikut, treguesin e rrezikut dhe të sigurisë.
3. Gjatë ruajtjes së substancave dhe preparateve kimike në magazina duhet të respektohen dhe vrotohen principet e pajtueshmërisë kimike
 - a) Substancat dhe preparatet shumë oksiduese vendosen të ndara nga substancat dhe preparatet lehtësisht të ndezshme.
 - b) Acidet dhe bazat do të vendosen të ndara.
 - c) Substancat dhe preparatet kimike, të cilat reagojnë si rezultat i përbërësve toksike të tyre, duhet të vendosen në vende të veçanta.

d) Substancat dhe preparatet kimike, në varësi të përmasave të tyre (të vëllimeve ose sasive) vendosen mbi stenda ose rafte të rrjeshtuara dhe të ndara njëra nga tjetra në largësi 1 m.

4. Në magazinat e kimikateve ndalohet rreptësisht depozitimi i ushqimeve ose silazheve.

5. Hyrja e njerëzve të paautorizuar dhe futja e kimikateve për të cilat nuk ka autorizim në territorin e magazinës parandalohen me masa administrative dhe masa të tjera efektive në varësi të natyrës së veprimtarisë. Shërbimi dhe mirëmbajtja e strukturave, pajisjeve dhe elementëve shtesë të magazinës duhet të administrohen në mënyrë efektive sipas natyrës dhe shtrirjes së veprimtarisë.

6. Punonjësit që merren me shërbimin, mirëmbajtjen dhe instalimet e qendrës së ruajtjes duhet të trajnohen dhe udhëzohen për veprimet e sigurisë, sipas nevojës në përputhje me natyrën dhe shtrirjen e shërbimit. Punonjësit e shërbimit duhet t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore periodike.

7. Depozitimi dhe ruajtja e kimikateve të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin i nënshtrohet procedurës së lejes dhe regjistrimit. Aplikimet për leje i drejtohen Ministrisë së Industrisë dhe të Energjitikës, ndërsa, për regjistrim, Ministrisë së Mjedisit. Pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës ngrihet komisioni për dhënie lejes, për depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme me përfaqësues nga Ministria e Industrisë dhe e Energjitikës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Mjedisit. Proçedura e marrjes së lejes dhe rregullorja e funksionimit të komisionit miratohen nga titullarët e ministrive të ngarkuara.

8. Çdo qendër që depoziton dhe ruan kimikatet e rrezikshme duhet të ketë një drejtues teknik, kimist, i cili të njohë mirë kimikatet, vetitë e tyre dhe i cili njeh rregulloren e trajtimit, të administrimit të kimikateve, si dhe masat për parandalimin e aksidenteve.

9. Substancat dhe preparatet kimike që ruhen në depo duhet t'i nënshtrohen kontrollit të vazhdueshëm nga personat që përgjigjen për to. Kontrolli përfshin kontrollet



periodike të depove dhe të vendeve të tjera të ruajtjes, kontrollin e stivave dhe rafteve, kontrollet e ambalazheve, si dhe analizat laboratorike periodike.

10. Kontrolli ka për qëllim të përcaktojë gjendjen cilësore dhe ndryshimet që ndodhin në procesin e ruajtjes dhe të bëjë ndarjen e materialeve që kërkojnë riparim dhe të materialeve në përdorim. Ambalazhet e dëmtuara, që kërkojnë riparim, duhet të zëvendësohen menjëherë. Depoja duhet të mbahet vazhdimisht në gjendje të rregullt dhe të pastër. Në rast dëmtimi depoja duhet të rikonstruktohet menjëherë.

8.MEKANIZMAT JO RREGULLATORE PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE

* Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin. Ky plan megjithëse u hartua me mbështetjen e të gjitha Ministrive të linjës dhe institucioneve kërkimore të tyre, ai nuk gjeti mbështetjen e duhur. Plani kishte mjaft veprime që duhet të ndërmerreshin, por ato nuk u realizuan për mungesë të planifikimit të fondeve të nevojshme në implementimin e këtij plani. Puna e Komitetit drejtues të këtij Plani dhe Ministria që e drejtonte këtë plan nuk u angazhuan për implementimin e tij. Megjithatë disa probleme në kuadrin e këtij plani filluan të marrin drejtimin e duhur.

* Iniciativa e ish-ministrisë së industrisë dhe energjitikës për të grumbulluar në një vend të sigurtë të gjitha kimikatet stoqe pavarësisht nga shkalla e rrezikshmërisë së tyre luajti një rol të rëndësishëm në parandalimin e rrezikut që i kanosej njerëzve, kafshëve dhe mjedisit nga prezenca e këtyre kimikateve jashtë kushteve të ruajtjes së sigurtë të tyre. Të gjitha shpenzimet për grumbullimin e rreth 100 tonë kimikate u përballuan nga fondet e kësaj ministrie. Subjekte private që i dispononin këto kimikate nuk merrnin përsipër as shpenzimet për riambalazhimin dhe transportin e tyre në një magazinë të sigurtë.

* Mungesa e kuadrit të plotë ligjor në procesin e privatizimit në veçanti për problemet

mjedisore ka lënë të pazgjidhur problemet e ndotjes historike, të akumuluar prej vitesh që tashmë i ngelen pronarit të ri të objekteve. Shteti duhet të marrë përsipër shpenzimet për rimbaltimin, transportin, ruajtjen dhe asgjësimin e kimikateve stoqe, duke përdorur mekanizma jorregullatore për stimulimin e këtij aktiviteti ashtu siç veprohet me grumbullimin e armëve.

* Niveli i publikimit dhe komunikimit me publikun i ulet. Botimi vetëm në Gazetën Zyrtare i ligjeve apo vendimeve është i pamjaftueshëm. Tryezat e rumbullakta të debatit, media e shkruar dhe elektronike pak të angazhuara. I vetmi rast i angazhimit të tyre ka qenë problemi i magazinimit të cianureve në magazinën e N.F.I.M-Elbasan. Dhe në këtë rast për mos njohje të problemeve dhe komunikim të dobët me strukturat përgjegjëse ka patur disinformim dhe me pasoja negative për zgjidhje të problemeve. Pavarësisht se tashmë ekziston një ligj për substancat dhe preparatet kimike jo të gjithë subjekte private, por edhe shtetërore e njohin dhe zbatojnë atë. Njerëzit kanë pak njohuri për kimikatet dhe në veçanti për ato të rrezikshmet. Mungesa njohurish ka në vetë punonjësit që merren me to sepse mungon informacioni dhe instruksionet e nevojshme për vetitë e substancave të rrezikshme, për masat e mbrojtjes, të planeve të sigurisë, emergjencës dhe ndihmës së parë etj. (*Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri, 2006*)

9. KRAHASIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË LIDHJE ME KIMIKATET ME UDHËZIMET E BE-SË

Duke vijuar procesin e Planit Kombëtar të Veprimit për Shëndetin dhe Mjedisin (NEHAP) dhe Children Environment and Health Action Plan for Europen (CEHAPE), ku Shqipëria është palë, ajo ka bashkëpunuar me OBSH dhe vendet e rajonit dhe në të ardhmen do të ndërtojë Setin e Indikatoreve të Mjedisit dhe Shëndetit. Në këtë grup indikatorësh bëjnë pjesë edhe grupi i indikatorëve për



LEVIZJA E GRUAS PËR ZHVILLIM INTEGRAL
ALBANIAN WOMAN'S MOVEMENT OF INTEGRAL DEVELOPMENT



kimikatet, ku parashikohet të krijohet regjistri dhe ndërkohë të mund të bëhet edhe vlerësimi i riskut në shëndet nga kimikatet.

MMPAU bazuar në informacionin e marrë nga Agjensitë Rajonale të Mjedisit si dhe kërkesave për ndërhyrje nga organet e qeverisjes lokale, ka identifikuar një numër hotspotesh, ish-qendra të dikurshme të industrisë kimike. Burim informacioni për hotspotet kanë qenë edhe programet e donatorëve për menaxhimin e kimikateve. Hotspotet e identifikuar janë bërë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit në Mjedis (2002).

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Konventën e Roterdamit dhe është duke ndjekur procedurat e ratifikimit, nëpërmjet hartimit të projektligjit për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit "Mbi procedurën e miratimit të mëparshëm të njoftuar për disa kimikate dhe pesticide të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare". Ky projektligj përforcon nevojën e krijimit të Byrosë së Kimikateve e cila do të realizojë përbushjen e detyrimeve që rrjedhin edhe nga Konventa e Bazelit dhe Stokholmit, në të cilat vendi është palë. Së bashku me Konventën e Bazelit dhe të Stokholmit, ajo plotëson kuadrin e nevojshëm juridik që rregullon lëvizjen ndërkombëtare të kimikateve të rrezikshme, duke shmangur rreziqe që vijnë prej tyre. Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me objektivat e Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së 2009-2014.

Në zbatim të PKZMSA 2009-2014 brenda tremujorit të parë të vitit 2010 do të përfundojë ratifikimi i Konventës së Roterdamit, e cila së bashku me Konventën e Bazelit dhe të Stokholmit plotësojnë kuadrin e nevojshëm juridik që rregullon lëvizjen ndërkombëtare të kimikateve të rrezikshme, duke shmangur rreziqe që vijnë prej tyre. Në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA 2009-2014 për adresimin e prioriteteve afatgjata është parashikuar si masë zbatuese për periudhën 2013-2014 krijimi i zyrës së regjistrimit të kimikateve. Sipas PKZMSA 2009-2014 implementimi i Rregullores së EC për Importin dhe Eksportin e Kimikateve të Rrezikshme (EC) 689/2008 është parashikuar të realizohet brenda vitit 2012.

Lidhur me mbledhjen e të dhënave për kimikatet, Ministria e Shëndetësisë nuk e ka një mekanizëm të tillë. Në të ardhmen në sektorin e Shëndetit Publik do të krijohet një "regjistër për aksidentet kimike" në bazë të rekomandimeve të OBSH.-së.



10. DEKLARATA

I. Duke qendruar gjithmonë në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, janë ndërmarrë hapa majft të shpejtë dhe efikase nga Ministria e Mjedisit, e cila ka hartuar dhe çuar për miratim një seri draft-ligjesh.

Këshu më datë 27.07.2010, në ambjentet e “Hotel Tirana”, Ministria e Mjedisit, prezantoi 3 projekt-vendime për trajtimin e tri kategorive mjaft specifike të mbetjeve urbane. Projekt-vendimet për trajtimin e “Amballazhet dhe Mbetjet e tyre”; “Për Bateritë dhe Akumulatorët”; “Për Mbetjet nga Paisjet Elektrike dhe Elektronike”, janë hartuar në bashkëpunim me IFC, në përputhje me standartet më të mira mjedisore të BE. Pikërisht këto tre projekt-vedime, vijnë në një moment, kur MMPAU është duke ecur me hapa të shpejtë drejt realizimit të prioritetit të saj madhor, përafrimit të legjislacionit mjedisor.

Në këtë takim ishte i pranishëm ministri i MMPAU, zoti Famir Mediu, kryetari i komisionit për çështjet e mjedisit dhe të bujqësisë në Parlament, zoti Jemin Gjana, drejtues të MMPAU dhe IFC, si dhe përfaqësues të bizneseve që trajtojnë mallrat e kategorizuara në këto projekt-vendime.

Në fjalën e tij, ministri Mediu, theksoi se “Këto tri akte janë pjesë e akteve nënligjore të ligjit për mbetjet dhe përgatitja e tyre bën të mundur që implementimi i ligjit me miratimin e tij të bëhet i plotë dhe eficient”. Duke vazhduar më tej në këtë kontekst, ministri Mediu u shpreh se ”Me këtë reformë, Legjislacioni Mjedisor përafrohet në masën 100% me direktivat e Bashkimit European. Përveç shkallës së përafrimit, këto akte përmbajnë objektiva, që synojnë krijimin e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e këtij kuadri ligjor, forcimin e institucioneve dhe përmbushjen e standardeve mjedisore ndërkombetare, si detyrime që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe programit të Qeverisë”.

Gjithashtu në fjalën e tij, ministri Mediu, u shpreh se përse i përket këtyre 3 projekt-vendimeve, shumë i rëndësishëm është edhe mendimi i grupeve të interesit, ekspertëve të fushës dhe shoqërisë civile.



II. Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik, Enver Rroshi më 24. 03.2011 paraqet në vija të përgjithshme Strategjinë menaxhuese për rrezikun e kimikateve.

Ai shprehet se: Të gjitha kimikatet që hynë e dalin në territorin shqiptar nga pikat doganore por edhe ato produkte që përmbajnë lëndë të rrezikshme kimike të emetuara në ajër por edhe në tokë nga prodhues vendas, do të jenë pjesë e një monitorimi të plotë të institutit të shëndetit publik për të shmangur kështu krijimin e vatrave të reja të nxehta në territorin shqiptar. Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik, Enver Rroshi sqaron se është ngritur tashmë një grup pune me ekspertë të Ministrisë së Shëndetësisë, Mjedisit por edhe ekspertë të huaj për të kordinuar kështu punën në hartimin e një strategjie të re të menaxhimit të kimikateve, bazuar në metodologjinë më të mirë ndërkombëtare. “Roli i ISHP-së në këtë rast është që të forcojë kapacitetet vendase në lidhje me zbatimin e rregullores ndërkombëtare të menaxhimit të kimikateve, pasi dihet që këto kimikate kanë efekte të dëmshme kur ato nuk menaxhohen si duhet në mjedis dhe shëndet”,- tha Rroshi. Sipas Rroshit objekt i monitorimit do të jenë edhe derdhjet e lëndëve kimike në zona të pacaktuara, duke anashkaluar faktin se ndotje të tilla prekin edhe shtretërit e lumenjve në zona të caktuara.

11. ZONAT PROBLEMATIKE QË SHFAQIN NDOTJE ME KIMIKATE NË SHQIPËRI

11.1 FUSHA NAFTËMBAJTESE E PATOS – MARINËZ

I. Fusha naftëmbajtëse e Patos Marinzës është një nga fushat më të mëdha në Europë sa i takon rezervave të naftës në brendësi të kontinentit. Fusha që përfshin një sipërfaqe prej rreth 160 km² u zbulua fillimisht në vitet 1928 dhe që atëherë është shfrytëzuar me ritme dhe teknologji të ndryshme. Ky shfrytëzim rreth 80 vjeçar i fushës ka patur përfitimet e tij ekonomike, por gjithashtu ka shkaktuar edhe një gjendje të papërshtatshme mjedisore që vërehet lehtësisht në terren. Rritja e



ndërgjegjjes shoqërore dhe krijimi i institucioneve mjedisore Shqiptare nuk mund të lënë pa adresuar këtë problem historik mjedisor i cili paraqitet në kontradiktë të plotë me standartet mjedisore dhe aspiratat e vendit në proceset integruese.

Në kuadër të përpjekjeve të Qeverisë për të realizuar një ndëryhrje të integruar për rehabilitimin mjedisor të fushës naftëmbajtëse Patos Marinze, Komisioni Evropian financoi një projekt që përfundoi në vitin 2008, i cili kishte dy qëllime kryesore:

- Vlerësimin e gjendjes mjedisore dhe shëndetësore të zonës Patos Marinze;
- Hartimin e planit të veprimit mjedisor dhe shëndëtsor për zonën

II. Gjendja e përgjithshme mjedisore dhe shëndetësore e zonës

Nga studimi për vlerësimin e gjendjes mjedisore dhe shëndetësore të zonës Patos Marinze u arrit të bëhej një vlerësim i qartë i shtrirjes së problemit të ndotjes dhe nevojës për ndërhyrje. Studimi konkludoi se në zonë janë të pranishme këto fenomene,

- Ndotja e tokës, ku u vlerësua se ekzistojnë rreth 1480 pellgje llumrash naftë duke zënë një sipërfaqe prej rreth 95 ha dhe duke përbërë edhe një ekspozim të hapur të banorëve ndaj kësaj ndotje.
- Ndotje e ujërave sipërfaqësore, ku u vlerësua se rreth 117 km trupa ujore janë të ndotura nga substancat/polimeret e naftës, këtu përfshihen ujërat e lumit Gjanicë, Seman dhe përrenjëve të zonës. Kjo gjendje e ujërave përben një rrezik direkt për zinxhirin ushqimor bujqësor si pasojë e përdorimit të ujit për ujitjen e tokave.
- Cilësia e ajrit, në zonë vërehet një ngarkesë e ajrit me substanca hidrokarbure volatile, sulfide të hidrogjenit apo okside të squfurit.
- Biodiversiteti, vlerësohet se duke përkeqësuar kushtet fiziko – kimike të burimeve natyrore dhe sidomos ujërave sipërfaqësore janë ndikuar negativisht vlerat biologjike të zonës.
- Shëndeti i banorëve, vërehet një gjendje shëndetësore e ndikuar negativisht nga gjendja mjedisore e zonës dhe kryesisht cilësia e ajrit dhe ujit të pijshëm të zonës.

- Dëmet ekonomike, gjendja mjedisore dhe shëndetësore ndikon direkt në sistemin e prodhimit ekonomik të zonës, rendimenti i ulët prodhimi bujqësor dhe rritja e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor vlerësohen si direkt të lidhura me situatën mjedisore të zonës. Siç rezulton edhe nga studimi përkatës evidentohet qartë se industria e naftës në zonën Patos Marinzë nuk është menaxhuar sipas standarteve mjedisore duke e renditur zonën përkrah rrjetit të vatrave të nxehta mjedisore që kanë nevojë për ndërhyrje dhe rehabilitim.

III. Plani i Veprimit Mjedisor dhe Shëndetësor në Patos Marinzë

Plani i Veprimit Mjedisor dhe Shëndetësor i Patos Marinzës i hartuar në vitin 2008 me mbështetjen e Delegacionit European ka për qëllim të realizojë një ndërhyrje të integruar në drejtim të rehabilitimit dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe shëndetit të banorëve në zonë.

Plani i Veprimit, bazohet në nevojat për ndërhyrje të evidentuara nga studimi pararendës, si dhe merr parasysh të shkuarën e zonës si dhe aspiratat e banorëve lokalë për përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe jetës. Ndërhyrjet e përcaktuara në Plan konsistojnë në tre shtylla kryesore:

- Veprimi i industrisë, për shmangien dhe reduktimin e ndotjes
- Ndërhyrjet mjedisore, që synojnë ndërprerjen e transferimit të ndotjes në receptorët mjedisorë
- Masa shëndetësore, që synojnë shmangien dhe kontrollin e ndikimeve negative në shëndetin e banorëve të zones.

Plani do të zbatohet në dy faza kryesore:

FAZA I - ku synohet të adresohen çështje prioritare që të rekurtojnë ndikimet potenciale të industrisë në mjedis dhe shëndet, me një shtrirje kohore prej rreth 3 vjet. Zbatimi me sukses i kësaj faze do të ndikojë ndjeshëm në gjendjen mjedisore të zonës.

FAZA II - synon zbatimin e masave në një periudhë më afatgjatë (20 vjet) që tentojnë të rrisin performancën e aktorëve konkretisht synohet në edukimin mjedisor

të banorëve, restaurim të pejsazhit, përmirësim të menaxhimit të mbetjeve etj. Për të zbatuar me sukses këtë plan nevojitet marrja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët e përfshirë duke filluar nga përmirësimet teknologjike të industrisë së naftës në zonë, hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit mjedisor të operacioneve të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, trajnim i stafit, ngritja e një rrjeti monitorues efektiv etj.

Kompania Bankers standart i operimit me standarte ndërkombëtare!

Kompania Bankers që prej vitit 2004 administron një pjesë të mirë të fushës naftëmbajtëse të Patos Marinzës. Kjo kompani për herë të parë po aplikon shfrytëzimin e puseve të naftës sipas standarteve ndërkombëtare të mjedisit, shëndetit dhe sigurisë duke sjellë një model bashkohor edhe për kompanitë e tjera të pranishme në zonë. Për një periudhë rreth 5-vjeçare kompania ka reduktuar ndjeshëm ndikimet e industrisë së naftës në mjedisin e zonës dhe ka ndihmuar në pastrimin e saj. Ndërtimi i një vend-depozitimi të posaçëm për trajtimin e llumrave të naftës në zonën e Zharrës është një investim konkret dhe i dukshëm i kompanisë në zbatimin e planit të veprimit mjedisor dhe shëndetësor. Në mbyllje dua të shpreh bindjen se edhe ky takim i sotëm përbën një kontribut pozitiv për zbatimin e Planit të Veprimit në Mjedis dhe Shëndetësi dhe zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi kombëtar. Rehabilitimi i kësaj zone, është një prioritet në punën e Ministrisë së Mjedisit, e cila ka hartuar edhe një plan masash për të. Në nëntor të vitit 2010 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, zhvilloi një tryezë pune për të shpalosur, Planin e Veprimit Mjedisor dhe Shëndetësor, për zonën e Patos-Marinzës. Në këtë tryezë ishin të ftuar edhe përfaqësues të Ministrisë së Energjetikës, të Ministrisë së Shëndetësisë, të Ministrisë së Financave, drejtuesit e kompanisë “Bankers Petroleum” që zhvillojnë aktivitet në këtë zonë, si dhe mjaft specialistë të MMPAU. Ministri i MMPAU, zoti Fatmir Mediu, e vlerësoi si mjaft të rëndësishëm, paraqitjen e këtij plani pune, i cili sipas ministrit Mediu, do t’i japë fund një herë e mirë gjendje mjaft të rëndë në këtë zonë naftëmbajtëse.

Ministri Mediu theksoi se rehabilitimi i zonave të nxehta, ndër të cilat bën pjesë edhe Patos-Marinza, është një ndër prioritetet e qeverisë shqiptare në programin e saj 2005-2013, gjithmonë me qëllimin e përmbushjes së standarteve mjedisore për ta afruar më



tej Shqipërinë me BE. Gjithashtu ministri Mediu bëri me dije se vitet në vijim, pritet që në këtë zonë të investohen rreth 10 milionë dollarë, financime nga IFC dhe EBRD, për rehabilitimin e kësaj zone, duke filluar që nga problemet shëndetësore e mjedisore, dhe deri në rehabilitimin e pejsazhit.

11.2 KIMIKATET NË DURRËS (ZONA E PORTO ROMANOS)

Porto Romano është afro 6.5 km dhe për shkak të pranisë për disa dekada të uzinës së kimikateve është shndërruar në epiqendër të projekteve strategjike të Bankës Botërore. Janë më shumë se 700 ton kimikate të transportuara për në shkretoret jashtë vendi, si dhe dhjetëra ton kimikate në fuçitë e vendosura në ish-magazinat e repartit të Bisht Pallës. Ish-uzina në veri të Durrësit është cilësuar si një ndër pesë vatrat më të rrezikshme në Ballkan për shkallën e lartë të ndotjes dhe që nga viti 2002 e deri më tani janë dhënë disa fonde. Fazat e zhvillimit të projektit shtrihet në vitin 2003-2005 dhe që ka konsumuar fonde të konsideruara. Fillimisht u realizua Studimi i Fizibilitetit me fondet e Bankës Botërore dhe objektivi që identifikimi i zonave të ndotura, vlerësimin e rrezikut mjedisor, identifikimin e zgjidhjeve teknike të përshtatshme. Më pas u izoluan kimikatet, u krye rrethimi i ish uzinës, hapja e një kanali 4 m të thellë dhe që ka përshkuar të gjithë hapësirën, ndërsa përfundoi edhe tamposja. Me fondet e qeverisë shqiptare dhe të pushtetit vendor familjet brenda zonës së infektuar u strehuan jashtë uzinës. Banorët kanë shfaqur në mënyrë të vazhdueshme probleme shëndetësore. Mjekët kanë vërejtur se një pjesë e banorëve të zonës kanë pësuar dëmtime serioze në zemër, mushkëri, apo probleme që kanë të bëjnë me sistemin nervor. Fare pranë ish uzinës së kimikateve gjendet edhe fusha me mbetje urbane, mbetje të cilat digjen në natyrë duke rritur ndotjen në zonë. Ndërtimi i landfilldit mendohet se do të zgjidhë një herë e përgjithmonë çështjen mjedisore në veri të Durrësit. Një landfill tjetër ka nisur vite më parë të ndërtohet në Shën Vlash. Ky landfill që do të përpunojë ujërat e zeza ka nisur të ndërtohet në vendin ku kanë qenë vite më parë vaskat e peshkut. Në Porto Romano, në vitin 2010 nisi ndërtimi i



landfillit të ri pikërisht në zonën ku 20 vite më parë uzina kimikate prodhonte lindan e squfur. Në Durrës ka qenë ministri i Mjedisit, Fatmir Mediu, dhe ministri i Ministrisë së Transporteve e Punëve Publike, Sokol Olldashi, për të deklaruar nisjen e investimit. Projekti synon të integrojë plotësisht këtë zonë me rrezikshmëri të lartë edhe për jetën e qytetarëve në një pjesë të sigurt ekologjike dhe të pastër bregdetare. Qeveria daneze e japoneze kanë treguar gatishmëri të afrojnë fonde së bashku me ato të Bankës Botërore për të realizuar projektin që do t'i jepte fund ndotjes së mjedisit, tokës dhe ujit në këtë pjesë të Durrësit.

11.3 STACIONI HEKURUDHOR, BAJZË

Bajza është një qytet i vogël (Komuna e Kastratit) e vendosur në pjesën veriore të Shqipërisë, rreth 15 km larg nga qyteti i Shkodrës. Stacioni hekurudhor i Bajzës ndodhet në breg të liqenit ndërkufitar të Shkodrës dhe i gjithë transporti hekurudhor për në dhe nga Mali i Zi, gjithashtu edhe pika doganore kalon nga stacioni hekurudhor i Bajzës. Në fillimet e viteve 1990 një sasi prej 200- 250 tonë pesticidesh të skaduara (Rrogor, vofatox, nogos, selinon, novakrom, spitsornit, 2-4 D, fugorat, sevin, lindan, etj.), kimikate industriale dhe materiale të tjera u bashkuan dhe u depozituan në magazinën e stacionit hekurudhor të Bajzës. Origjina e pesticideve nuk është shumë e qartë, megjithatë gjatë viteve 1991-1992, kompania Gjermane Schmidt-Cretan importoi dhe magazinoi përkohësisht në Bajzë 480 ton kimikate të rrezikshme. Nga këto kimikate, më të rrezikshmet ishin toxaphene dhe phenyl mercury acetate, të dyja të ndaluara në BE nga viti 1983. Edhe pse pjesa më e madhe e këtyre pesticideve u kthyen në Gjermani në vitin 1993 për shkatërrim të sigurtë, banorët nga zonat përreth morën fuqitë të cilat i zbrazën direkt në stacionin e trenit dhe nëpër magazinë. Gjithashtu është raportuar se shumë bagëti të cilat kullojnë rreth magazinës dhe në pjesën kodrinore të stacionit hekurudhor, kanë ngordhur pas këtij incidenti. Për më tepër, në vitet e mëvonshme peshkatarët e liqenit të Shkodrës kanë raportuar ngordhje në masë të peshkut në liqen. Nëpërmjet këtij Projekti synohet rehabilitimi i plotë i pikës së nxehtë mjedisore të Bajzës. Aktualisht afro 200 ton pesticide të skaduara dhe



kimikate të tjera janë depozituar prej më shumë se 15 vjetësh në magazine që ndodhen në stacionin hekurudhor të Bajzës. Në letrën që komuniteti lokal i dërgoi ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave thuhet se pesticide të skaduara si: rrogor, vofatox, nogos, selinon, novakrom, spitsornit, 2-4 D, fugorat, sevin, lindan, etj përbëjnë vetëm një pjesë të sasisë që është shtuar si rezultat i përzierjes së kimikateve të rrezikshme me produkte të tjera si lëkura.

12. RAPORTIME NË MEDIA

Rasti 1:

Shqiptarët thithin në ditë 1 kg kimikate të rrezikshme nga mbetjet plastike

Rreth 1 kilogram elementë ndotës thith çdo shqiptar në ditë, nga kimikatet e rrezikshme të ndotjes. Ndërsa, pjesa më e madhe e shqiptarëve e konkretisht 80 përqind e tyre rrezikohen çdo ditë, nga Bisfenoli A i cili është një nga elementët vdekjeprurës e shkaktar i sëmundjeve hormonale por edhe një sërë sëmundjesh të tjera të rrezikshme siç janë ato kanceroze apo autizmi. Sipas studimeve të ISHP-së por edhe nga statistikat e bëra publike nga ambientalistët 800 mijë ton në vit kimikate do të shkarkohen çdo vit në vendin tonë nëse situata e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe atyre plastike do të vazhdojë të jetë pa vëmendje nga organizmat shtetërorë. Situata në vend përse i përket, riciklimit apo menaxhimit të mbetjeve të plastikës duket se është krejt e panjohur, por nga ana tjetër rreziku që këto mbetje shkarkojnë është i pranishëm në çdo moment të jetës tonë. Në një takim organizuar ditën e djeshme nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është prezantuar për herë të parë, një film dokumentar i titulluar “Planeti Plastik” prodhim i Werner Boote kushtuar tërësisht problemit të ndotjes nga materialet plastike. I pyetur nga gazeta “SOT” se përse ka zgjedhur vendin tonë për të promovuar filmin dokumentar e çfarë mendon për gjendjen e ndotjes nga plastika në vend, producenti i filmit Thomas Bogner, ka deklaruar se në fakt ai njihet shumë pak me gjendjen e ndotjes në vend e ka ardhur me



ftesë të REC për të kryer një fushatë ndërgjegjësimit për të gjithë opinionin shqiptar. Agjensia e Mjedisit ka ndërmarrë këtë fushatë ndërgjegjësimit gjithashtu për të sensibilizuar opinionin publik sesa e dëmshme është ndotja nga plastika por edhe nga mbetjet e tjera urbane. Në këtë takim mori pjesë edhe Edlira Mulla eksperte për menaxhimin e mbetjeve, e njëkohësisht edhe pedagoge në Universitetin Politeknik. Nga statistikat që paraqiti ekspertja mbetjet plastike janë tepër të rrezikshme, e shkarkojnë në ajër një sërë elementesh që mund të jenë shkak i sëmundjeve hormonale, por edhe sëmundjeve të autizmit. Sipas ekspertes ky element aktual që po rinon përditë e më shumë ambientin në vend ka krijuar një situatë emergjente për vendin edhe pse shqiptarët njihen shumë pak me rrezikun që shfaq ndotja nga plastika. Ndër të tjera, specialistja ka deklaruar se nga ana e organizmave shtetërore deri më tani nuk është kryer qoftë edhe një studim i vetëm, dhe instancat shtetërore janë tepër indiferentë në lidhje me këtë problem.

Ndërgjegjësimi

Ndërgjegjësimit dhe veprim për një të ardhme më të sigurt. Sipas statistikave nëse prodhimi i mbetjeve plastike nuk do të ndalet e të mos merren masa për reduktimin apo riciklimin e mbetjeve plastike, por edhe atyre urbane vendi ynë do të arrijë të prodhojë në vit rreth 800 ton në vit mbetje plastike, e për këtë shkak edhe sëmundjet kanceroze do të kapin kulmin. 22 mijë ton mbetje në vit prodhohen në kryeqytet, e sipas statistikave Tirana është qyteti që prodhon më shumë mbetje sesa të gjithë qytetet e tjera në vend. Mbetjet e plastikës shtohen në familjet shqiptare 10 për qind më shumë nga viti në vit. Ndërsa nga ana tjetër mbetjet urbane shtohen 10.5 për qind gjatë çdo viti. Në shumë raste kudo në ambientet ku ne jetojmë vëmë re se mbetjet urbane digjen pa kriter e bashkë me to edhe mbetjet plastike digjen në ajër duke shkaktuar në organizimin tonë e duke mbushur mushkëritë tona me një kimikat që sipas specialistëve quhet Bisfenoli A. Ky element ka në përbërje të njëjtat veti si estrogjeni duke depërtuar në receptorët njerëzorë e duke shkaktuar një sërë sëmundjesh gjenetike, e kanceroze, por edhe sëmundje të tjera që kanë të bëjnë me hormonet. Bisfenoli A gjendet në shishet e polikarbonateve dhe në kanaçet e



ushqimeve dhe pijeve. Ai mund të kalojë edhe në ushqimet apo pijet që nga ambalazhi ku ato mbahen e në këtë mënyrë mund të shpërndahet me lehtësi në organizimin tonë.

Ekspertët e menaxhimit të ndotjeve: Plastika, shkak për kancer e autizëm

Ndotja nga plastika, duket se është krejtësisht e panjohur për vendin tonë e në këtë kontekst shqiptarët nuk janë të informuar sesa e rrezikshme mund të jetë një mjet i cili duket shumë funksional siç mund të jetë një pjatë plastike e cila nëse vendoset në mikrovalë e çliron më shpejt e më saktë elementin e dëmshëm që në këtë rast është Bisfenoli A. E në këtë mënyrë organizimi i njeriut është më i ndjeshëm e përcjell direkt këtë element në receptorët e organizimit. As më shumë e as më pak ky shembull u deklarua ditën e djeshme nga specialistja Edlira Mulla e cila deklaroi gjithashtu se shumica e shqiptarëve nuk janë absolutisht të njohur me rrezikun që i kanoset nga ndotja prej plastikës. Sipas specialistes qendrat amerikane për kontrollin e sëmundjeve dhe shmangien e tyre kanë raportuar se 93 % e njerëzve kanë nivele të dallueshme të Bisfenoli A në urinën e tyre. Ekspozimi i lartë i foshnjave premature në inkubatorë në sallat e terapisë intensive ndaj Bisfenoli A dhe ftalateve, e në këtë formë përbën një problem mjaft shqetësues për shëndetin e tyre. 80 % e bebeve dhe pothuajse të gjithë të rriturit kanë nivele të matshme të ftalateve në trupat e tyre. Ftalatet përdoren si plastifikues në prodhimin e ambalazheve të ushqimeve, pajisjeve mjekësore dhe në materialet e ndërtimit plastike. Specialistja ka deklaruar gjithashtu se ndotja e plastikës në vendin tonë është rrezik i sigurt për një sërë sëmundjesh kanceroze, apo sëmundjeve të autizmit. Sipas saj edhe organizmat shtetërore duhet të kryejnë politika të reja që në çdo produkt të jenë të detyrueshme e të publikohen rreziqet nga kimikatet përbërëse të plastikave. Gjithashtu të etiketohen produktet plastike sipas përbërësve të rrezikshëm që përmbajnë ose jo, sipas rregullave ndërkombëtare. Konsumatori ka të drejtë të informohet. Të dekurajohet importi i qeseve dhe shisheve plastike me anë të taksave të larta. Të mos jepen më falas qeset dhe shishet plastike nëpër markete. Të mos lejohet përdorimi i ambalazheve prej qesesh të ricikluara ose jo. Por edhe të përdoret letra dhe qeset me karton të fortë si ambalazh. Ka shumë fakte se monomerët që përdoren për prodhimin e polimerëve të plastikave janë të njëjtët kimikate që mund ta dëmtojnë mjedisin dhe sidomos njerëzit.



Për shembull, klori është një kimikat i rrezikshëm për njerëzit. Polivinil kloruri, (PVC) që përmbajnë materialet plastike të ambalazheve përmban 56.8 % në masë klor në të, pra më tepër se gjysma e masës së PVCsë është klor. Po ashtu, kimiketet që u shtohen plastikave absorbohen nga trupat e njerëzve. Disa prej këtyre komponimeve kimike është gjetur se i ndryshojnë hormonet dhe sjellin probleme të tjera shëndetësore të njerëzit. Mbetjet plastike mund të zbërthehen gradualisht në përbërësit e tyre kimikë dhe të çlirojnë toksina të cilat janë të dëmshme ndaj mjedisit, gjallesave dhe publikut të gjerë. Disa kimikate, të tilla si Bisfenoli A mund të shkaktojnë probleme serioze në shëndet. Madje sipas disa studimeve, edhe doza të vogla të Bisfenoli mund të shkaktojnë probleme në zhvillimin e fëmijëve.

13. ZHVILLIMI DHE KONKLuzionET E PYETËSORIT

Qëllimi i këtij pyetëtori është që të masë nivelin e ndërgjegjësimit tek blerësit përsa i përket kimikateve të lodrave.

Pyetjet i janë drejtuar 40 blerësve pasi ata kanë dalë nga dyqanet e lodrave për fëmijë. Përzgjedhja e kampionimit ka qënë rastësore.

Nisur nga përgjigjet e dhëna nga personat e kontaktuar, mësohet se konsumatorët nuk janë të informuar në shkallë të madhe përsa i përket materialeve me të cilat përbehen lodrat. Nëse kihet parasysh edhe numri i personave që nuk u intereson materiali me të cilat përbehen lodrat, atëhere del qartë në pah, se informacioni për materialin me të cilat përbehen lodrat, nuk është në nivelin e duhur, as nga personat që duhet ta japin, qofshin këto autoritet publike, qofshin këta private, apo ndoshta edhe nga vetë konsumatorët të cilat duhet ta kërkojnë këtë informacion.

Duke parë përgjigjen e pyetjes 3, del se konsumatori shqiptar, megjithëse nuk ka dijeni përsa i përket materialeve me të cilat përbehen lodrat, në momentin e përzgjedhjes arrin të bëjë dallimin, vetëm duke u nisur nga pamja ose prekja me dorë, duke identifikuar drurin dhe plastikën. Ndërsa për materialet e tjera, me të cilat mund



të përbëhen, nuk ka informacion dhe nuk e bën një zgjedhje të tillë, ë bazuar në këtë element.

Mungesën e informacionit në lidhje me lodrat dhe rrezikshmëriëe e tyre, e pasqyron më së miri edhe përgjigjia e dhënë për pyetjen 4, e cila nxjerr në pah shumë mirë, se megjithëse lodrat mund të kenë certifikimin e tyre përse i përket standarteve të prodhimit, vetëm një pjesë shumë e vogël arrin ta “përkthejë” atë në risqe për fëmijët. Ideja e një konsumatori të çoroditur, pra që nuk di çfarë zgjedh, del gjithashtu edhe pyetjet 5 dhe 6, ku vetëm një pjesë e vogël e tyre, ka pasur informacion me lodrat e rrezikshme në treg, ndërkohe që indiferenca për të përqaftuar ose edhe kërkuar informacion, ngelet e theksuar. Gjithashtu, rastet e blerjes së lodrave të rrezikshme apo të pa rrezikshme qofshin ato, ngelet në dorë të rastësisë, pasi mungesa e informacionit, për lëndet me të cilat prodhohen apo edhe njohja e shenjave certifikuese, nuk është në nivele të kënaqshme.

Duke iu referuar pyetjeve 7 dhe 8, mësohet se konsumatorët shqiptarë kanë prirje për të qenë të kujdeshëm vetëm kur kanë informacion, gjë të cilin e marrin vetëm kur iu ofrohet dhe nuk është se e kërkojnë vetë.

Idenë, se konsumatorët shqiptarë janë të prirur vetëm për të marrë informacione të rastësishëm dhe të mos ta kërkojnë vetë informacionin mbi sigurinë e lodrave, del edhe njëherë te pyetja 9, ku pjesa më e madhe e të anketuarve, nuk di se ku të drejtohet nëse një lodër mund të sjellë rrezikshmëri për fëmijën.

Duke analizuar përgjigjet e marra për pyetjen 10, kuptohet se konsumatori shqiptarë, është i prirur të jetë rastësor në përzgjedhjen e lodrave, duke u nisur thjesht nga pamja e tyre, qoftë edhe funksioni, por duke mos menduar për çmimin, i cili në vetevete është edhe një tregues për cilësinë e materialeve të prodhimit gjithmonë në rast se lodrat janë të certifikuara.

Përse i përket përgjigjeve të grumbulluara për pyetjen 11, shikohet se konsumatori është i prirur që të ketë një farë sigurie në përzgjedhjen e lodrave, dhe këtë e pretendon vetëm te pika e blerjes, e cila i jep një farë sigurie, pa marrë parasysh çmimin ose materialin me të cilin përbëhen lodrat.


Ndërsa përgjigjet e dhëna për pyetjen e fundit, saktësojnë edhe një herë karakterin indiferent të konsumatorit shqiptar, i cili duke mos qenë aspak i përgjegjshëm për

materialin e lodrave, fokusohet në përzgjedhjen e tyre thjesht duke u nisur nga funksioni ose përmbushja e një qëllimi të caktuar, pa u ndalur aspak te rrezikshmëria që mund të sjellë një material përbërës, për të cilin nuk është në dijeni.

11.1 ANALIZIMI

1.A jeni në dijeni të materialeve që përbëhen lodrat?

Po –	29
Jo –	15
Nuk më intereson -	6




2. A i zgjidhni lodrat në bazë të materialeve që ato përbëhen?

Po – 24

Jo – 18

Nuk më intereson - 8




3.A i zgjidhni lodrat duke u nisur nga emri i firmës apo thjesht nga funksioni dhe pamja e tyre?

Po :33 (nga emri i firmës)


Jo: 12 (nga emri i firmës, por nga funksioni dhe pamja)

Nuk më intereson: 5




4.A jeni në dijeni për shenjat dalluese, që çertifikojnë sigurinë e lodrave?

Po – 7
 Jo – 28
 Nuk më intereson - 5




5.A keni dëgjuar për lodrat e përbëra nga material të rrezikshme?

Po – 26
 Jo – 12
 Nuk më intereson - 2




6.A keni blerë ndonjeherë të tilla?

Po –	8
Jo –	28
Nuk më intereson -	4



7.A jeni në dijeni të bllokimeve të herëpashershme që autoritetet përkatëse, i kanë bërë lodrave të rrezikshme, të hedhura në tregjet shqiptare?

Po –	17
Jo –	23
Nuk më intereson -	0




8.Nëse jeni në dijeni të lodrave të rrezikshme, a jeni treguar selektiv përsa i përket zgjedhjes së lodrave?

Po – 28

Jo – 11

Nuk më intereson - 1




9.A jeni në dijeni se kush është autoriteti që duhet të kontrollojë tregjet përsa i përket sigurisë së lodrave?

Po – 8

Jo – 28

Nuk më intereson - 4




10.A besoni në cilësinë e lodrave, nisur nga çmimi me të cilin ato shiten?

Po – 10


Jo – 25

Nuk më intereson - 5



11.Ku preferoni t'i bleni lodrat:

- në dyqane të zakonshme; 24
- në dyqane enkas për lodrat; 8
- apo në tregje te hapura? 8




12.A keni dëgjuar për lodrat me aromë dhe a jeni në dijeni të efekteve që ato kanë te fëmijët?

Po – 10

Jo – 28

Nuk më intereson – 2





Produktet dhe Siguria Kimike në Ballkan Bashkëpunimi i Shoqërisë Civile në *acquis* komunitare, vlerat për konsumatorët dhe përgjegjësia e bashkëpunimit

PYETËSOR

Në këtë pyetësor do të ruhet anonimat, kështu që ju lutem tregohuni sa më të sinqertë në dhënien e përgjigjeve të pyetjeve.

Qëllimi i këtij pyetësori është që të masë nivelin e ndërgjegjësimit tek blerësit përsa i përket kimikateve të lodrave.

Pyetjet i janë drejtuar 40 blerësve pasi ata kanë dalë nga dyqanet e lodrave për fëmijë.

PYETJET

1- Jeni blerës të rregullt të lodrave për fëmijë?

- a) Po, i blej rregullisht
- b) Jo, vetëm me raste

2- A keni dijeni për llojin e materialeve që përdoren për lodrat?

- a) Po, jam i/e informuar
- b) Jo, nuk jam i/e informuar

3- A ndikon materiali i lodrave në zgjedhjen tuaj ?

- a) Po
- b) Ndonjëherë
- c) Jo

4- A i zgjidhni lodrat duke u nisur nga emri i firmës apo nga funksioni i tyre?

- a) I zgjedh nga emri i firmës
- b) I zgjedh nga funksioni që ato kanë

5-A jeni në dijeni për shenjat dalluese, që çertifikojnë sigurinë e lodrave?

- a) Po, jam në dijeni
- b) Jo, nuk jam në dijeni

6-A keni dëgjuar që disa lodra përbëhen nga materiale të rrezikshme për fëmijën?

- a) Po, kam dëgjuar
- b) Jo, nuk kam dëgjuar

7-A keni dëgjuar për lodrat me aromë dhe a jeni në dijeni të efekteve që ato kanë te fëmijët?

- a) Po, jam në dijeni
- b) Jo, nuk jam në dijeni

8- A jeni në dijeni të bllokimeve të herëpashërshme që autoritetet përkatëse, i kanë bërë lodrave të rrezikshme, të hedhura në tregjet shqiptare?

- a) Po, kam dëgjuar
- c) Jo, nuk kam dëgjuar

9- Nëse po, a jeni treguar selektiv përsa i përket zgjedhjes së lodrave?

- a) Po
- b) Jo

10- A jeni në dijeni se kush është autoriteti që duhet të kontrollojë tregjet përsa i përket sigurisë së lodrave?

- a) Jo, nuk e di
- b) Po, e di

11-Nëse Po, a keni pasur rast t'i drejtoheni ndonjëherë për të paraqitur ndonjë ankesë në lidhje me lodrat që keni blerë?

- a) Po, jam ankuar
- b) Jo, nuk jam ankuar

12-A besoni në cilësinë e lodrave, nisur nga çmimi me të cilin ato shiten?

- a) Po, çmimi varet nga cilësia
- b) Ndonjëherë çmimi justifikon cilësinë
- c) Jo, çmimi nuk justifikon cilësinë

13-Ku preferoni t'i bleni lodrat:

- a) Në dyqane të zakonshme;
- b) Në dyqane enkas për lodrat;
- c) Në tregje të hapura?

BIBLIOGRAFIA

Aneksi I (Dokumenta zyrtare)

- 1- Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri, 2006
- 2- Plani Kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim- Asocimit, 2007-2012
- 3- Studimi i vitit 2008 i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) “Trajtimi i kimikateve të rrezikshme, gjendja në ndërmarrjet dhe shoqëritë, në varësi të METE ”
- 4- Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin, 2002

Aneksi II (Legjislacione)

Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike”

Ligji nr. 7747, datë 29.07.1993 “Për ratifikimin i konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre”

Ligji Nr.8934, datë 5.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

Ligji Nr.8990, datë 23.01.2003 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”

Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”

Ligji Nr.9010, datë 13.02.2003 ‘Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”

Ligji Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura”

Ligji nr.8531, datë 23.09.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”

VKM Nr. 888, datë 19.12.2007, “ Për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave”

Vendimin nr. 824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme

Aneksi III (Web-side)

<http://lajme.shqipëria.com>

<http://al.westernbalkansenvironment.net>



Projekti implementohet nga LGZHI



Projekti udhëhiqet nga WECF



Ky publikim u mundësua me asistencën financiare të BE-së.
Përmbajtja e këtij publikimi është në përgjegjësi të organizatës LGZHI dhe
absolutisht nuk reflekton në pikëpamje të BE-së.